



# Një Qendër Rinore e drejtuar nga vetë të rinjtë

Nga përvoja e Qendrës Rinore në Kuçovë



QËNDRA RINORE  
KUÇOVË



Save the Children



# Një Qendër Rinore e drejtuar nga vetë të rinjtë

Nga përvoja e Qendrës Rinore në Kuçovë



QËNDRA RINORE  
KUCOVË



**Save the Children**

Mars 2008

**Autorë:** Anduena Shkurti, Juliet Kosarzycki dhe Ryan Smith

**Redaktimi letrar:** Olta Çakçiri

**Save the Children in Albania**  
**Programi i Mbrojtjes së Fëmijëve**

Koordinatorë e Programit: Anduena Shkurti

**Botues: Save the Children in Albania**

Rr. Komuna e Parisit ,Vila "Lami"

Tiranë, Shqipëri. Tel.: +355 4 266227 ose 261840

e-mail: [savealbania@savealbania.org](mailto:savealbania@savealbania.org)

P.O. Box 8185

Shtypur nga: Siena

Tirazhi: 1000

© 2008 **Save the Children in Albania**

Përmbajtja e këtij botimi mund të përdoret apo kopjohet lirisht për qëllime jo fitimprurëse, me kusht që çdo riprodhim i tillë të shoqërohet me njohjen e Save the Children si burim.

# Pasqyra e lëndës

<b>Parathënie</b> .....	<b>5</b>
-------------------------	----------

---

## **I. Jo vetëm qendër rinore - qendër rinore e drejtuar**

<b>nga vetë të rinjtë</b> .....	<b>7</b>
1. Nga dhe si të fillosh .....	8
2. Rekrutimi i të rinjve dhe sidomos i atyre nga grupet minoritare, më të varfërve dhe të përjashtuarve .....	10
3. Ngritja e kapacitetit të të rinjve dhe punonjësve të qendrës .....	12

---

## **II. Struktura organizative** .....

<b>14</b>	
1. Bordi Rinor drejtues .....	14
2. Procedura e zgjedhjes .....	19
3. Punonjësit e qendrës rinore .....	20

---

## **III. Si dhe çfarë aktivitete mund të organizohen** .....

<b>21</b>	
1. Si organizohen aktivitetet .....	21
2. Ide për aktivitete me dhe për të rinjtë .....	26

---

## **Shtojcat** .....

<b>34</b>	
Shtojca 1: Shembuj të dobishëm për organizimin dhe funksionimin e qendrës .....	34
Shtojca 2: Shembuj të dobishëm për planifikimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e aktiviteteve .....	39
Shtojca 3: Trajnimi i të rinjve “Të rinjtë për të rinjtë” .....	61

---

*‘.....Unë jam bërë anëtar i bordit që 14 vjeç. Qendra Rinore është i vetmi vend në qytetin tim ku të rinjtë janë në krye të listës. E rëndësishme është që ne këtu kemi mundësinë të vëmë në pah energjinë rinore që na karakterizon. Nga aktivitetet e zhvilluara në Qendrën Rinore unë kam zhvilluar më shumë ndjenjën e pjesëmarrjes, përgjegjësinë qytetare, aftësinë për të pranuar të ndryshmen si dhe guximin për të mbrojtur të drejtat e mia dhe të shokëve. Në Qendrën Rinore unë kam qenë organizator i shumë aktiviteteve, por po përmend aktivitetin “Unë, Ti dhe Mjedisi” si dhe programin “Lidershipi”. Përfshirja në aktivitete kërkon kohë dhe angazhim, por vërtet ia vlen ....’*

**Eltoni, 18 vjeç, nxënës/ ish anëtar i Bordit Rinor 2005**

*Aktivitetet e larmishme në Qendrën Rinore më kanë bërë më të sigurt në vetvete. Ndjenja e të qenit i dobishëm në komunitet është gjëja më e bukur.*

**Orneli, 16 vjeç, nxënës/President i Bordit**

*‘... ne kalojmë këtu një pjesë të mirë të kohës sonë. Këtu mësova se ç’është dhe si mund ta drejtojmë një projekt rinor. Tani ndihem e lirshme për të folur përpara njerëzve të panjohur e për të kundërshtuar mentalitetin mosbesues që ekziston ndaj të rinjve. Marr pjesë në të gjitha aktivitetet dhe kam drejtuar edhe një projekt kundër korrupsionit në shkollat tona.....’*

**Florida, 16 vjeç, nxënëse/Anëtare e Bordit Rinor**

*‘Përfshirja në aktivitetet e Qendrës Rinore ka qenë një nga gjërat më të bukura në 4 vitet e gjimnazit. Trajnimet dhe debatet më kanë ndihmuar në zhvillimin e aftësive komunikuese, drejtuese dhe të punës në grup. Këtu vij për t’iu larguar monotonisë së jetës së përditshme..... Këtu gjej vendin ku mund të shpreh idetë e mia dhe t’i realizoj ato bashkë me miqtë e mi.’*

**Jona, 18 vjeç, nxënëse/Anëtare e Bordit Rinor**

# Parathënie

Tungjatjeta!

Ky manual është shkruar si për ata që duan të bëhen pjesë e nismave rinore të drejtuara nga vetë të rinjtë, ashtu edhe për ata që duan të dinë më shumë rreth projektit “Qendra Rinore”

“Qendra Rinore” është një nga projektet e Save the Children in Albania për mbrojtjen e fëmijëve<sup>1</sup> dhe i ka rrënjët tek programi “Masat kundër trafikimit të fëmijëve në Evropën Juglindore”, i zbatuar në Shqipëri që prej vitit 2002. Përveç synimit të tij kryesor që është parandalimi dhe mbrojtja e fëmijëve nga trafikimi dhe fenomene të tjera negative, ai synon të zbulojë mënyrat nëpërmjet të cilave fëmijët apo të rinjtë që për arsye të ndryshme ekonomike apo shoqërore janë të pafavorizuar apo të përjashtuar mund të vetëfuqizohen dhe të fitojnë shprehitë e domosdoshme për t’u integruar plotësisht në shoqëri. Objektivat e këtij projekti përfshijnë gjithashtu mobilizimin e komunitetit dhe autoriteteve lokale në mbështetje të pjesëmarrjes aktive të të rinjve, mbështetjen e nismave të veçanta për fëmijët dhe të rinjtë më të pafavorizuar si dhe dokumentimin dhe vlerësimin e punës së bërë.

Ky manual përfshin përvojën e punës së përbashkët të të rinjve, punonjësve dhe profesionistëve që realizuan krijimin dhe funksionimin e qendrës rinore në Kuçovë. Ai mund t’u japë ide praktike të gjithë atyre që punojnë (ose që duan të punojnë) drejtpërdrejt me të rinjtë, sidomos atyre që janë të angazhuar në projekte rinore komunitare.

Shembulli i Qendrës Rinore Kuçovë që përshkruhet në këtë manual mund të shërbejë si model për nisma të tjera të ngjashme, por nuk pretendon të jetë më i miri në çdo rrethanë. Ai nuk është domosdoshmërisht një model i gatshëm i praktikave më të mira, por veçse një shembull i provuar i një qasjeje të suksesshme në punën me rininë.

Kjo përvojë na tregon se të rinjtë dhe ata që punojnë me ta akoma ndeshin sfida të mëdha si skepticizmi dhe mosbesimi nga të rinjtë dhe ndaj të rinjve, gjithëpërfshirja e të rinjve më të pafavorizuar, sigurimi i parave për aktivitete etj.

Ne shpresojmë që manuali t’u shërbejë edhe partnerëve, trajnuesve, donatorëve apo të interesuarve të tjerë për punën me rininë. Për këtë arsye ne kemi përfshirë në këtë manual metodologjinë, si dhe një përmbledhje të sesioneve të trajnimit për formimin e të rinjve trajnerë.

Ju urojmë lexim të këndshëm.

Anduena Shkurti  
Save the Children in Albania

---

<sup>1</sup> Sipas Konventës për të Drejtat e Fëmijës, fëmijë quhet çdo qenie njerëzore nën moshën 18 vjeç.



# I. Jo vetëm qendër rinore – Qendër e drejtuar nga vetë të rinjtë

Ideja për një program parandalues për trafikimin dhe fenomenet negative që prekin të rinjtë, deri diku u nis nga të rriturit (Save the Children) në përgjigje të nevojës për të luftuar këtë fenomen të kohëve të fundit për Shqipërinë. Trafikimi lidhet me kolapsin që pësoi papritur ekonomia dhe me tronditjen e jetës së shumë individëve dhe familjeve që filluan ta shohin emigracionin dhe jetesën jashtë vendit si të vetmen mënyrë për të mbijetuar. Kjo u shfrytëzua nga trafikantët, viktimë e lakmisë së të cilëve u bënë shumë fëmijë e të rinj.

Me qëllim hartimin e projekteve parandaluese ndaj trafikimit, Save the Children in Albania organizoi në vitin 2001 - 2002 disa takime dhe konsultime me fëmijë dhe të rinj, prindër, mësues dhe drejtues të pushtetit lokal në disa fshatra dhe qytete.

Ideja për themelimin e Qendrave Rinore për Zhvillim Social i ka rrënjët pikërisht në këto konsultime, sidomos në ato që patëm me të rinjtë e moshës 14 – 18 vjeç nga Cërriku dhe Kuçova. Ne kuptuam se shumica e tyre nuk donin të largoheshin nga familja apo vendi i tyre, por nuk u mbetej asnjë alternativë. Ata u ankuan se nuk kishin se ç'të bënin dhe se në qytetin e tyre nuk kishte gjasa që të gjenin punë. Shumë përmendën se marrëdhëniet me prindërit apo me të rriturit nuk ishin të mira. Në veçanti vajzat thanë se prindërit nuk u jepnin aspak liri apo hapësirë për t'u shoqëruar apo për të dalë me shoqe e shokë.

Kur i pyetëm se ç'do të thotë sipas tyre të jesh një i ri në qytetin ku ata jetojnë, të rinjtë u përgjigjën:

*'Ne nuk jemi të lirë, ne s'bëjmë dot asgjë'.*

*'...ç'të bëjmë?... vetëm shtyjme kohën; kemi vetëm diellin që na ngroh.'*

Mbas shumë konsultimesh, Save the Children in Albania vendosi të mbështesë krijimin e qendrave rinore në Cërrik dhe Kuçovë. Ne zgjodhëm këto dy qytete të vogla sepse jo vetëm ishin të rrënuara ekonomikisht (Kuçova ka shkallën më të lartë të papunësisë në vend, 60,2%<sup>2</sup>), por edhe njihen si qytete prej nga janë trafikuar shumë fëmijë.

Meqenëse pjesëmarrja kuptimplotë e të rinjve është parësore për punën tonë, kujdes i veçantë iu kushtua shpjegimit të rëndësisë që ka pjesëmarrja e të

---

<sup>2</sup> Burimi: zyra e statistikës Kuçovë

rinjve në çdo etapë të kësaj nisme. Kështu, që në fillim, u prezantua edhe ideja e qendrës rinore të drejtuar nga vetë të rinjtë, e cila u bë edhe 'vlera e shtuar' e këtij projekti pasi, të paktën në Kuçovë dhe Cërrik, çdo nismë apo projekt për fëmijët dhe të rinjtë (ndonjë i organizuar nga qendra kulturore) organizohej dhe zbatohej vetëm nga të rriturit. Koncepti i pjesëmarrjes kuptimplotë të të rinjve në këtë projekt ka qenë jo vetëm vlere e shtuar por në të njëjtën kohë edhe sfida më e madhe e projektit, sidomos në vitin e parë të zbatimit. Kjo për arsye se pjesëmarrja e të rinjve ishte koncept relativisht i ri (2002), por edhe për shkak të rezistencës dhe skepticizmit që ekzistonte jo vetëm tek të rriturit (mësues, punonjës NGOsh, prindër etj.) por edhe tek vetë të rinjtë.

*'.....e pse të lodhemi?...Kush pyet për ne?...Ne jemi kot, të gjithë na paragjykojnë'.*

Por, shumica e tyre ishin entuziastë. Ata krijuan grupin bërthamë për ngritjen dhe drejtimin e qendrës, i cili më vonë u shndërrua në bordin rinor drejtues.

*..... jeta këtu del nga e zakonshmja. Këtu kalojmë një pjesë të kohës së lirë duke u argëtuar por edhe duke nxënë. Këtu kam shumë shokë, shkëmbejmë mendime, debatojmë, luajmë, krijojmë. Këtu ne jemi ne.*

Edhe anëtarë të komunitetit, mësues, prindër, përfaqësues të pushtetit lokal dhanë ndihmesë të çmuar. Ndonëse paksa skeptikë në fillim, ata u impresionuan kur panë se ç'ishin të aftë të bënin të rinjtë.

*'Ne do t'i mbështesim me forcë të rinjtë në përpjekjet e tyre për të drejtuar qendrën rinore. Të rinjtë e meritojnë'* – tha nënkryetari i Bashkisë.

Ndërsa drejtori i Drejtorisë Arsimore shtoi, *'Është hera e parë që në Kuçovë ne kemi një mjedis ku të rinjtë vetëvendosin dhe drejtojnë'.*

## I. Nga dhe si të fillosh

Të rinjve iu dha mundësia t'i jepnin formë projektit dhe të merrnin pjesë në diskutimin dhe zbatimin e të gjitha aspekteve të tij. Por, vlen të përmendet se qëllimi, drejtimet kryesore dhe buxheti i projektit ishin paracaktuar. Ata kishin në dorë që, nëpërmjet bordit rinor, të bënin vetë detajimin e planit të aktivitetit si dhe ta zbatonin atë me ndihmën e punonjësve të qendrës. Këtyre dhe të gjithë personave të tjerë të përfshirë në këtë nismë iu bë i qartë roli dhe influenca që do të kishin të rinjtë mbi procesin dhe rezultatet e punës së qendrës.

*Pjesëmarrja në aktivitetet e Qendrës Rinore më ka ndihmuar të zhvilloj aftësitë e mia komunikuese, leadershipin dhe mendimin kritik. E vlerësoj si shumë të çmuar përvojën e fituar në Qendrën Rinore Kuçovë*

**Orsiola, 21 vjeç, studentel/ Ish anëtare e Bordit Rinor 2003**

*Në Qendrën Rinore ndërthuret bukur mundësia për argëtim, informim dhe zhvillim të aftësive. Në qendër jam ndjerë e vlefshme, për veten dhe shokët. Një përvojë që nuk do ta harroj kurrë.*

**Ediola, 19 vjeç, studentel/ Ish anëtare e Bordit Rinor 2005**

Përveç pjesëmarrjes kuptimplotë, një tjetër aspekt i rëndësishëm është bashkëpunimi me partnerët lokalë dhe ndarja me ta e përgjegjësive dhe e pronësisë së nismës që në fillim. Autoritetet lokale (Bashkia dhe Drejtoria e Arsimit) siguruan pa pagesë mjediset e qendrës, të cilat u rinovuan dhe u përshtatën për t'u bërë sa më miqësore për të rinjtë. Qendra ka bibliotekën, sallën e mbledhjes, pajisje dhe vegla për aktivitetet muzikore dhe sportive, fusha pingpongu, kompjutera, qendër zëri dhe pajisje të tjera audio dhe video si dhe një fushë sportive për volejball dhe basketboll.

Qendra drejtohet nga Bordi Rinor i përbërë nga djem dhe vajza 14 – 18 vjeç. Ata ndihmohen nga punonjësit e paguar të qendrës të cilët fillimisht paguheshin nga Save the Children, ndërsa më vonë nga vetë Bashkia. Fillimisht të rinjtë përcaktuan rregulloren e funksionimit të qendrës dhe hartuan planin e aktiviteteve. Përveç aktiviteteve sociale dhe kulturore ata organizuan debate mbi disa çështje shqetësuese për ta si marrëdhëniet, demokracia, droga etj. Më pas ata u trajnuan si 'të rinj trajnerë' për të fituar aftësitë dhe besimin e nevojshëm në trajtimin e çështjeve të ndryshme sociale me bashkëmoshatarët e tyre.

*Qendra Rinore më fal shumë energji pozitive dhe për mua është si një shkollë e dytë që më ka ndihmuar në plotësimin e personalitetit. Këtu ne marrim e japim me njëri-tjetrin. Kam mësuar gjëra të reja dhe besoj se këto do të më ndihmojnë përgjatë gjithë jetës. Të gjitha këto jam përpjekur t'i ndaj me të tjerët duke organizuar dhe drejtuar trajnime të ndryshme mbi tema që na shqetësojnë ne të gjithëve.*

**Idit, 17 vjeç, nxënëse**

Ata ishin entuziastë dhe kishin plot ide për aktivitetet në vijim. Gradualisht ata fituan jo vetëm aftësi, por edhe besimin se mund t'ia dilnin mbanë me sukses punës drejtuese në qendër. Kështu, zëri u përhap dhe numri i fëmijëve dhe të rinjve që merrnin pjesë në aktivitetin e qendrës rinore u rrit dita-ditës.

*'Kjo qendër është gjëja më e mirë që kemi. Vetëm këtu unë e ndiej veten të lirshëm dhe mendoj se çdo i ri këtu mund të shprehë dhe të vërë në jetë mendimet e tij. Në fakt, në shumë institucione mendimi i të rinjve as që merret parasysh. Të frekuentosh Qendrën Rinore është një avantazh i madh sepse aty mund të jesh vetja, mund të mësosh diçka të re dhe mund të njihesh me shumë të rinj të tjerë. Marr pjesë në çdo aktivitet me kënaqësi dhe disa prej tyre unë i kam drejtuar vetë.*

**Edmondi, 17 vjeç, nxënës**

Pjesëmarrja kuptimplotë e të rinjve kërkon kohë dhe, mbi të gjitha, kërkon burime financiare, mjete dhe mbështetje të kualifikuar. Kualifikimi i të rinjve për drejtimin e qendrës si dhe trajnimi i metodës 'të rinjtë për të rinjtë' kërkon po ato burime dhe mjete si edhe projektet për të rriturit. Ndaj edhe nevoja për financim dhe angazhim afatgjatë në mbështetje të kësaj nisme është një tjetër aspekt i rëndësishëm për sigurimin e suksesit. Përvoja jonë vërtetoi se, sikurse bashkëpunimi me autoritetet lokale, të pasurit e një burimi të mirë financimi i lehtëson mjaft gjërat dhe se buxheti mund të jetë përcaktues i suksesit apo dështimit.

Për këtë nismë, Save the Children in Albania nisi bashkëpunimin me të rinjtë dhe Bashkinë e Kuçovës në vitin 2002, por vetëm në vitin 2007 Bashkia nënshkroi marrëveshjen për marrjen e plotë të përgjegjësisë për financimin e qendrës rinore.

Ndërkohë ne ndoqëm të njëjtat hapa, procedura dhe qasje edhe për qendrën rinore në Cërrik, por nuk mundëm të realizojmë të njëjtin bashkëpunim reciprok e, për rrjedhojë, nuk mundëm të sigurojmë vazhdimësinë.

## **2. Rekrutimi i të rinjve dhe sidomos i atyre nga grupet minoritare, më të varfërve dhe të përjashtuarve**

*Këtu të gjithë ndihen të rëndësishëm dhe të aftë për të arritur edhe gjërat më të vështira. Shumë nga ne erdhën këtu të ndrojtur, të veçuar, por tani gjithkush ndihet i mirëpritur. Aktivitetet janë interesante, sidomos ato që i ideojmë dhe drejtojmë vetë. Këtu kuptova rëndësinë dhe kënaqësinë e punës në grup, por edhe që të mos i kushtoj shumë rëndësi mentalitetit. Kam organizuar dhe drejtuar disa aktivitete në komunitet si dhurimi i librave për fëmijët e familjeve në nevojë, drejtimi i trajnimit 'Vlerat që u nevojiten të rinjve për të qenë të suksesshëm' etj.*

**Drieda, 16 vjeç, nxënëse**

Qendra rinore tërheq në mënyrë të natyrshme plot të rinj. Natyrshëm këtu mblidhen të gjithë të rinjtë që kanë dëshirë për punë dhe që janë të gatshëm të marrin pjesë në të gjitha aktivitetet jashtëshkollore. Me ta është e thjeshtë dhe kënaqësi të punosh, por në përgjithësi këta gëzojnë jetë familjare normale, kanë mjedisin e tyre mbrojtës dhe, në përgjithësi, nuk kanë shumë nevojë për ndonjë ndihmë të veçantë. Ata mund të përfitojnë prej faktit që qendra rinore u krijon mundësinë të përfitojnë njohuri të reja si dhe i përgatit ata të bëhen liderë të së ardhmes apo trajnerë. Por, një qendër rinore duhet të bëjë përpjekje maksimale që t'i krijojë këto mundësi për të gjithë, edhe për fëmijët dhe të rinjtë nga minoritetet, më të varfrit, më të shpërfillurit e të lënë pas dore që nuk afrohen po kaq natyrshëm në qendrën rinore.

*Si shumë nga ne, kur erdha për herë të parë në qendër mendova se këtu mund të merrja një libër për të lexuar apo thjesht të dëgjoja muzikë. Më pas kuptova se në qendër kishte vend për mua sikurse për të gjithë të tjerët, pavarësisht nëse ishin nxënës të shkëlqyer apo jo. Qendra Rinore është i vetmi vend në qytetin tonë ku të gjithë të rinjtë, pavarësisht origjinës apo statusit shoqëror dhe ekonomik, kanë mundësi jo vetëm të argëtohen por edhe të shpëlojnë aftësitë e tyre organizative dhe drejtuese. Unë vetë kam organizuar aktivitete të ndryshme si debate, aktivitete krijuese, kursin e gatimit... dhe jam e kënaqur.*

**Geralda, 16 vjeç, nxënëse**

Ekzistojnë disa arsye pse këta të rinj mund të tërhiqen dhe përfitojnë më shumë nga qendra rinore sesa të rinjtë me prejardhje më të begatë. Një arsye është se prindërit e tyre nuk kanë mundësi që të paguajnë për kurse jashtëshkollore dhe në qendër këto ofrohen pa pagesë. Disa prej tyre jetojnë me të afërmit dhe nuk i kanë prindërit pasi këta mund të kenë emigruar, disa jetojnë në familje me probleme sociale dhe disa të tjerë mund të kenë probleme që nuk dihen as prej familjeve apo shkollës së tyre. Disa as nuk shkojnë në shkollë. Për ta qendra rinore është një mundësi e mirë për zhvillim dhe edukim joformal.

Bashkëpunimi me organizata të ndryshme që mbrojnë interesat e tyre është me shumë vlerë. Në Kuçovë qendra rinore ka nisur bashkëpunimin me organizatën e Romëve Amarodrom. Megjithatë, si nga pikëpamja kulturore ashtu edhe nga mënyra se si funksionojnë, këto dy struktura janë të ndryshme. Ky bashkëpunim kërkon këmbëngulje pasi është pothuajse e pamundur që të punosh me të rinjtë e këtij komuniteti pa krijuar lidhjet me organizatën e tyre. Kjo punë mund të shpenzojë shumë mund dhe kohë, megjithatë bashkëpunimi është i rëndësishëm.

Na u desh kohë që t'u shpjegonim drejtuesve të komunitetit rom në Kuçovë për rëndësinë e aktiviteteve të organizuara në qendrën rinore. Për shembull, një program si ai i "aftësive për jetën" mund të duket si i pavlerë për komunitetin dhe kulturën e tyre, por aftësitë për jetën janë shumë të rëndësishme për këta të rinj jashtë komunitetit të tyre. Një mënyrë për t'ia dalë mbanë një vështirësie të tillë është ta ndërthurësh programin e aftësive për jetën me kurse më tërheqëse për ta si ai i muzikës, i kompjuterit apo i gjuhëve të huaja.

Puna me rininë të jep një shans të mirë edhe që të punosh me prindërit dhe të rriturit. Prindërit shpesh nuk e kuptojnë se ç'është një qendër rinore dhe mund të jenë dyshues apo hezitues për pjesëmarrjen e fëmijëve të tyre në aktivitetet e kësaj qendre. Me prindërit duhet treguar mirëkuptim dhe ata duhet të lejohen që të vijjnë e të shohin se si e shpenzojnë kohën në qendrën rinore fëmijët e tyre. Ky është një rast i mirë për të ngritur kapacitetin e prindërve, organizatave, liderave të veçantë apo gjithë komunitetit. Drejtuesit e organizatave Rome mund të mos kenë njohuri mbi si të përcaktojnë qëllime apo të krijojnë plane aktivitete. Megjithëse një gjë e tillë mund të shpenzojë më shumë kohë, ky është një rast i mirë për t'i përfshirë ata në planifikimin e aktiviteteve. Në këtë mënyrë ata do të informohen edhe mbi ç'aktivitete organizohen në qendër.

Një mënyrë tjetër është puna me një grup të vogël të rinjsh. Ekzistojnë aktivitete prej të cilave të rinjtë nga minoritetet, më të varfrit, më të shpërfillurit e të lënë pas dore mund të përfitojnë mjaft. Këto janë aktivitetet që u sigurojnë të rinjve aftësi për jetën në tema të tilla si jeta familjare, përcaktimi i qëllimeve e deri edhe drejtësia sociale dhe shëndeti seksual. Metoda e trajnimit të tyre nëpërmjet të rinjve trajnerë është ide shumë e mirë. Të rinjtë që janë më aktivë në qendrën rinore mund të trajnojnë të rinj nga komuniteti rom apo tjetër dhe më pas këta të fundit trajnojnë edhe të tjerë. Gjithsesi, ideja më e mirë është të uletsh e të bisedosh me vetë të rinjtë e t'i pyesësh ata se për çfarë janë të interesuar të trajnohen. Kjo ju jep mundësi të kuptoni se cilat janë problemet që ndeshin të rinjtë si edhe shqetësimet dhe interesat e tyre.

### **3. Ngritja e kapacitetit të të rinjve dhe punonjësve të qendrës**

Trajnimi dhe ngritja e kapacitetit të të rinjve por edhe e punonjësve të qendrës i parapriu çdo aktiviteti në qendrën rinore. Ngritja e kapacitetit mund të realizohet në mënyra të ndryshme. Në rastin e qendrës rinore në Kuçovë, kjo u realizua nëpërmjet trajnimeve të strukturuar, por edhe nëpërmjet diskutimeve për hartimin dhe zhvillimin e planeve apo ideve të ndryshme për aktivitetet, nëpërmjet udhëheqjes apo dhënies së modelit, nëpërmjet trajnimit gjatë përfshirjes në

punë etj.. Trajnimet u fokusuan kryesisht në rritjen e aftësive dhe njohurive të punonjësve të qendrës lidhur me pjesëmarrjen e të rinjve dhe kontributin që ata mund dhe duhet të japin në çdo nismë që ka të bëjë me ta.

Të rinjtë u trajnuan kryesisht për metodën ‘të rinjtë për të rinjtë’ me qëllim përdorimin e kësaj teknike në trajnimet, debatet apo diskutimet me bashkëmoshatarët e tyre. Gjithashtu, një vëmendje e veçantë iu dha edhe trajnimit apo pajisjes së të rinjve me disa aftësi që ndihmojnë drejtpërdrejt në zhvillimin tyre personal dhe social – të menduarit kritik, pranimi dhe respektimi i mendimit ndryshe, zgjidhja e mosmarrëveshjeve, negociimi etj.. Në shtojcën I japim detajet e trajnimit të të rinjve sipas metodës ‘të rinjtë për të rinjtë’.

## II. Struktura Organizative

### I. Bordi rinor drejtues

Qendra rinore drejtohet nga bordi rinor i cili luan rol kryesor në përmbushjen e misionit të qendrës. Të rinjtë janë ndihmuar që ta marrin gradualisht këtë rol vendimmarrës në mënyrë që opinionet dhe mendimet e tyre të bëhen vendimtare në aktivitetin e qendrës rinore. Një bord rinor bën të mundur që të ekzistojë një 'grup bërthamë' të rinjsh që aktivizohet në mënyrë shumë aktive në qendër. Ky grup është në pozitë të favorshme për të drejtuar aktivitete, për të marrë pjesë në to, për të shërbyer si model për bashkëmoshatarët dhe për të nxitur pjesëmarrjen në qendër. Në përgjithësi, bordi i të rinjve përbëhet nga të rinj me përvoja të ndryshme, të rinj që kanë qenë për pak kohë aktivë në qendrën rinore ose të rinj fare pa përvojë, të sapoardhur në qendër por të gatshëm dhe me ide të reja.

Edhe brenda bordit, disa të rinj duhet të marrin përgjegjësi dhe role drejtuese. Për shembull, Presidenti i Bordit mban përgjegjësi për punën e bordit dhe e përfaqëson atë. Nëse ai është i paaftë apo nuk ka vullnetin e duhur për të qenë drejtues, pjesëtarët e tjerë të bordit duhet të zgjedhin një president të ri. Për një grup të rinjsh të shkollës së mesme, kjo është një përgjegjësi e madhe dhe për këtë arsye ata kanë nevojë për udhëzime dhe trajnim. Që të realizojnë përgjegjësitë e tyre, ata duhet të ndiejnë kënaqësinë e suksesit dhe të kuptojnë rëndësinë që kanë brenda grupit. Njohja dhe vlerësimi i kontributit të tyre janë gjithashtu të rëndësishëm. Të rinjtë e bordit (shumica) ndjekin shkollën dhe kanë detyrime ndaj familjes apo rrethit të tyre shoqëror kështu që përfshirja në aktivitetin e qendrës kërkon prej tyre që të sakrifikojnë kohë, gjë që ata e bëjnë jo vetëm për të fituar rol prej lideri brenda grupit të të rinjve por edhe që qendra rinore të përmirësohet dita-ditës.

Për sa i përket projekteve (seri aktivitete) rinore që kërkojnë kohë dhe angazhim nga disa persona dhe për periudha të caktuara, mënyra më efikase për t'i realizuar është nëpërmjet një skuadre. Kjo skuadër është një grup prej dy ose më shumë personash që përcaktohen/emërohen nga bordi rinor për të drejtuar një projekt (seri aktivitete) në qendrën rinore. Skuadra e informon bordin rinor në lidhje me aktivitetet gjatë mbledhjeve të bordit. Anëtarët e bordit japin përshtypjet për punën e skuadrës (skuadrave) si dhe e mbështesin atë sipas nevojës. Secila prej skuadrave për projektet dhe aktivitetet ka nga një drejtues të grupit. Një shembull i punës së këtyre skuadrave është: mbikëqyrja e bibliotekës dhe e përdorimit të saj nga të rinjtë anëtarë të qendrës; mbarëvajtja e aktivitetit

të klasave të kompjuterit; planifikimi dhe zbatimi i ndonjë projekti masiv por që organizohet vetëm një herë apo krijimi dhe drejtimi i një klubi brenda qendrës që do të funksionojë për një kohë të gjatë (si klubi i artit, i fitnesit etj.).

Puna dhe aktiviteti i bordit rinor duhet të monitorohet si dhe të inkurajohet nga punonjësit e punësuar në qendrën rinore për këtë qëllim. Marrëdhëniet midis këtyre dy palëve janë shumë të rëndësishme dhe suksesi i punës së tyre varet prej njëri-tjetrit. Një punonjës, detyra kryesore e të cilit është të koordinojë programin për rininë, nuk mund të planifikojë dhe ekzekutojë aktivitete pa mbështetjen e bordit rinor. Po kështu, bordi rinor nuk mund ta drejtojë qendrën rinore pa mbështetjen e një lehtësuesi apo koordinatori. Marrëdhënia mes tyre duhet të jetë e përfutimit reciprok.

Të rinjtë e qendrës rinore e kanë dokumentuar të gjithë informacionin e duhur në lidhje me zgjedhjen dhe funksionimin e bordit rinor në rregulloren e bordit. Kjo përmban një paketë rregullash për funksionimin dhe qeverisjen e bordit dhe skuadrave përbërëse të tij. Rregullorja përfshin rolin dhe përgjegjësinë e bordit, procedurat e votimit dhe të zgjedhjes si dhe rrugëzgjidhjet dhe alternativat në rast se shfaqet ndonjë problem ose mosmarrëveshje. Këto rregulla duhet të jenë të detajuara dhe të qëndrueshme por në të njëjtën kohë edhe koncize (jo shumë faqe).

### **Përgjegjësitë më kryesore të Bordit Rinor:**

1. Përcakton dhe mbron Misionin dhe Qëllimet e qendrës rinore
2. Rekruton, punëson dhe mbikëqyr drejtuesin<sup>3</sup> e qendrës rinore<sup>4</sup>
3. Mbështet drejtuesin. Vlerëson kryerjen e detyrës së drejtuesit
4. Planifikon aktivitetin e qendrës në bashkëpunim me drejtuesin
5. Përfshihet drejtpërdrejt në mbledhjen e fondeve dhe krijimin e burimeve të qëndrueshme
6. Ndhmon drejtuesin në planifikimin dhe menaxhimin financiar
7. Përcakton dhe monitoron programin e qendrës rinore
8. Promovon dhe zgjeron imazhin e qendrës rinore
9. Vetëvlerëson kryerjen e detyrës së Bordit

<sup>3</sup> Drejtuesi i qendrës rinore është një punonjës social dhe kryen kryesisht funksionin e koordinimit të programit të Qendrës Rinore

<sup>4</sup> Në rastin e qendrës rinore Kuçovë që mbështetet me fonde të Bashkisë dhe Save the Children, drejtuesi i qendrës është rekrutuar dhe punësuar nga një panel i përbërë prej një përfaqësuesi të bordit rinor, një të Bashkisë dhe një të Save the Children.

## **Përgjegjësitë e Anëtarëve të Bordit:**

### **Presidenti:**

Përgjegjësitë kryesore të presidentit mund të kushtëzohen nga dy gjëra: motivimi i tij (ose mungesa e motivimit) për këtë pozicion dhe roli baraspeshë i anëtarëve të bordit ndaj dëshirave të presidentit. Presidenti është 'përfaqësuesi ekzekutiv' i bordit, i ngarkuar dhe përgjegjës drejtpërdrejt për mbikëqyrjen e mbarëvajtjes së punës dhe realizimit të përgjegjësisë të bordit. Presidenti kryeson mbledhjet e bordit, harton dhe shpërndan programin e mbledhjes (shiko më poshtë) dhe garanton që mbledhjet t'i përmbahen programit të prezantuar. Presidenti, më tepër se kushdo tjetër në bord, ka rolin përfaqësues të Qendrës Rinore. Që të sigurohet se anëtarët e tjerë e përfaqësojnë bordin në mënyrë pozitive, presidentit i duhet të jetë shumë i përfshirë dhe prezent në qendër dhe ta konsiderojë veten përgjegjës jo vetëm për veprimet e veta por edhe për ato të bordit. Presidenti është anëtar i bordit dhe nuk gëzon privilegje të veçanta. Ai voton ashtu sikurse të gjithë anëtarët e bordit.

### **Zëvendëspresidenti:**

Zëvendëspresidenti është një lider tjetër i bordit rinor. Ai ndihmon presidentin në detyrat e veta dhe realizon çdo detyrë tjetër që i ngarkojnë. Në rast se presidenti nuk ka mundësi të ushtrojë detyrën e vet, atëherë zëvendësohet nga zëvendëspresidenti. Për shembull, në rast se presidenti është i sëmurë ose nuk ka mundësi të jetë prezent, zëvendëspresidenti e përfaqëson atë zyrtarisht. Zëvendëspresidenti nuk ka detyra specifike e të përcaktuara, por megjithatë është një nga drejtuesit e bordit. Nëse personi i zgjedhur për këtë pozicion ka tendencën që të mos marrë përsipër përgjegjësi, ky pozicion mund të shndërrohet shumë thjesht në një pozicion pa rëndësi. Për këtë arsye, zëvendëspresidenti duhet të inkurajohet që të krijojë/marrë vetë përgjegjësi drejtuese në bord.

### **Financieri<sup>5</sup>:**

Financieri është përgjegjës kryesor për financat e qendrës. Kur anëtarët e bordit kanë nevojë për një prezantim të situatës financiare, atëherë i kërkojnë financierit një raport. Të dhënat për një raport të tillë financieri i merr nga personat e punësuar të qendrës – drejtuesi apo koordinatori. Financieri jep opinion për çështjet dhe vendimet financiare, por nuk jep vendimin përfundimtar për çështjet e financës. Është në përgjegjësinë e financierit që të ndihmojë drejtuesin e qendrës për çështje finance, të kërkojë prej tij shpjegime për situatën financiare apo të prezantojë kërkesë për fonde. Financieri e mban bordin të informuar në lidhje me situatën financiare të qendrës.

---

<sup>5</sup> Ky është shqipërimi i bërë nga anëtarët e bordit të qendrës rinore për thesarmbajtësin

**Sekretari:**

Sekretari mban shënim diskutimet kryesore dhe vendimet e marra gjatë mbledhjes së bordit rinor. Këto shënime të mbledhjeve të bordit u bëhen më pas të ditura jo vetëm anëtarëve të bordit, por edhe drejtuesit të qendrës si dhe kujtdo që është i interesuar<sup>6</sup>. Sekretari mban përgjegjësi për arkivimin e këtyre shënimeve sipas një sistemi të caktuar dhe të sigurt. Sekretari është gjithashtu përgjegjës për komunikimin, për njoftimet si dhe për promovimin si të bordit ashtu edhe të aktivitetit të qendrës rinore. Sekretari mban edhe kalendarin e aktiviteteve si dhe është përgjegjës për të ruajtur informacionin e nevojshëm për anëtarët e bordit.

**Anëtarët e tjerë të bordit:**

Bordi nuk përbëhet vetëm nga katër persona që mbajnë funksionet e mësipërme. Bordi përbëhet nga një numër tek anëtarësh dhe në rastin e Qendrës Rinore nga 9 të rinj. Të qenët anëtar i bordit do të thotë të mbartësh shumë përgjegjësi dhe të vësh në dispozicion kohën tënde. Anëtarëve të bordit u bëhet e qartë që në fillim se ata do të jenë përgjegjës për drejtimin e qendrës rinore. Ata duhet të jenë të motivuar dhe të marrin iniciativë për veprimtari të ndryshme e jo të presin udhëzime nga kryesia e bordit ose drejtuesi i qendrës. Bordi është vendimtar në përcaktimin e veprimtarisë së qendrës rinore dhe kur të rinjtë ia dalin mbanë në realizimin e këtij funksioni ndihen akoma më përgjegjës dhe përfshihen me shumë seriozitet dhe vendosmëri në rolin e tyre si anëtarë të bordit rinor.

**Këto janë disa nga rregullat dhe detyrat kryesore të anëtarit të bordit rinor:**

1. Merr pjesë rregullisht në mbledhjet e bordit si dhe në takime të tjera të rëndësishme.
2. Angazhohet me seriozitet dhe merr pjesë aktivisht në aktivitetet e qendrës rinore.
3. Merr përsipër me dëshirë dhe shërben vullnetarisht për realizimin e plotë dhe në kohë të detyrave dhe aktiviteteve të qendrës rinore.
4. Gjithmonë informohet për detyrat e bordit, përgatitet për mbledhjet dhe rishikon dhe komenton raportimet e prezantuara nga bordi.
5. Njihet dhe shoqërizohet me anëtarët e tjerë të bordit dhe krijon me ta marrëdhënie skuadre.

<sup>6</sup> Në rastin e qendrës rinore Kuçovë, kopje të këtyre shënimeve i dërgohen drejtorisë përgjegjëse në bashki dhe Save the Children

6. Është pjesëmarrës aktiv në procesin e planifikimit dhe vlerësimit vjetor të aktivitetit të qendrës rinore.
7. Anëtarët duhet të marrin pjesë në të gjitha mbledhjet e bordit. Nëse për të marrë një vendim duhet të votohet prej anëtarëve, atëherë duhet të jetë prezent patjetër një korum anëtarësh, përndryshe nuk ka votim.

### **Pritshmëritë për anëtarët e bordit:**

- Anëtarët duhet të marrin pjesë në aktivitetet e qendrës rinore
- Anëtarët duhet të drejtojnë 24 aktivitete në vit, të shpërndara nga dy në muaj

### **Kriteret për t'u zgjedhur në bord:**

- Të rinjtë duhet të jenë 15 deri 18 vjeç, djem dhe vajza që ndjekin ose jo shkollën e mesme
- Anëtarët e bordit që ndjekin shkollën duhet të jenë nga të dy shkollat e mesme të qytetit<sup>7</sup> dhe duhet të përfaqësojnë prejardhje dhe etni të ndryshme
- Të rinjtë mund të jenë anëtarë të bordit vetëm për dy vjet, duke u dhënë mundësi edhe të rinjve të tjerë të marrin pjesë në bord. Kur koha e tyre si anëtarë të bordit mbaron, ata ende mund të marrin pjesë në mbledhje dhe të jenë aktivë në drejtimin e qendrës, por pa të drejtë votimi.

### **Anëtarët pa të drejtë votimi:**

Pjesëtarë të tjerë të komunitetit, të rinj ose jo, janë të mirëpritur për të marrë pjesë në mbledhjet e bordit. Kjo u jep atyre mundësinë të shikojnë se si funksionon qendra e si merren vendimet dhe, sipas rastit, të japin idetë e tyre. Mbledhjet e bordit nuk janë sekret, por ata që nuk janë anëtarë nuk mund të votojnë.

**Skuadrat e bordit:** Siç u përmend më sipër, për të diskutuar dhe trajtuar një çështje të caktuar, anëtarët e bordit krijojnë mes tyre skuadra. Kjo për arsye se një grup i vogël mund të zgjidhë një çështje apo mision të caktuar më mirë dhe më shpejt sesa i gjithë bordi. Këto skuadra mund të krijohen për të planifikuar apo programuar një ngjarje apo një situatë. Skuadrat duhet të përbëhen nga të paktën dy anëtarë

---

<sup>7</sup> Në Kuçovë ka 2 shkolla të mesme, një të përgjithshme dhe një profesionale. Kriteret në këtë manual i referohen qendrës rinore të Kuçovës

të bordit dhe mund të përfshijnë edhe stafin e qendrës apo ndonjë person të jashtëm prania e të cilit është miratuar nga bordi. Anëtarët e skuadrës duhet të zgjidhen nga bordi dhe, për krijimin e skuadrës, duhet shumica e votave prej anëtarëve. Secila skuadër duhet të ketë një person përgjegjës për drejtimin e punës. Raportimet për punën e skuadrave i prezantohen bordit në çdo mbledhje.

## 2. Procedura e zgjedhjes

Bordi duhet të zgjidhet çdo vit<sup>8</sup>. Anëtarët e bordit inkurajohen që të qëndrojnë në bord për më shumë se një vit në mënyrë që të fitojnë përvojën dhe sigurinë e duhur në qendrën rinore dhe punën e bordit.

Njoftimi për zgjedhjet bëhet nga anëtarët aktualë të bordit dhe drejtuesi i qendrës rinore të paktën një javë përpara ditës së zgjedhjeve. Që nga kjo kohë fillojnë kandidimet. Një i ri ose e re mund të kandidojë veten ose të kandidohet nga një shok/shoqe. Në rastin kur një kandidat sugjerohet nga një person tjetër, ai duhet të pranojë nominimin për kandidat. Afati për sugjerimin e kandidaturave mbaron një ditë përpara zgjedhjeve, në fund të ditës (sipas orarit të qendrës). Procedurat për anëtarët që kandidojnë për herë të dytë janë të njëjta si për ata që kandidojnë për herë të parë.

Bordi duhet të inkurajojë pjesëmarrjen në zgjedhje të shumë të rinjve apo edhe anëtarëve të tjerë të komunitetit. Për këtë arsye, njoftimi për zgjedhjet duhet të afishohet jo vetëm në qendër dhe shkolla, por edhe në mjedise të tjera që frekuentohen nga të rinjtë. Çdo i ri që është aktiv në aktivitetin e qendrës rinore duhet të marrë pjesë në votim. Kështu votimi do të bëhet nga të rinj që e kanë të qartë përgjegjësinë e të qenit anëtar i bordit, çfarë është qendra rinore dhe cilat janë përfitimet e përfshirjes në bord. Drejtuesi i qendrës vëzhgon procesin dhe siguron që ky të jetë i drejtë, që kandidaturat të jenë gjithëpërfshirëse dhe jo vetëm mes shokësh.

Të gjithë dëgjojnë përpara votimit fjalimet e kandidatëve që mund të jenë edhe deklarata me shkrim. Deklaratat duhet të përmbajnë informacionin e duhur që votuesit të kuptojnë nëse të kandiduarit janë të përshtatshëm për këtë pozicion, në kanë qenë apo jo aktivë në qendrën rinore dhe pse duan të jenë anëtarë bordit. Duhet të keni parasysh se kjo nuk është vetëm një garë

<sup>8</sup> Meqë shkolla fillon në shtator, fund i shtatorit mund të jetë një kohë e këshillueshme për zgjedhjet e bordit.

popullariteti (megjithëse është pothuajse e pamundur që ta eliminosh këtë element krejtësisht) dhe votuesit duhet të vendosin se për kë të votojnë bazuar në meritat e kandidatëve.

Nëse votimi perceptohet si një ndodhi ku gjithkush është i ftuar dhe kryhet brenda një kohe të shkurtër, atëherë kandidatët duhet të mbajnë një fjalim të shkurtër. Nëse votimi do të kryhet gjatë gjithë ditës në mjediset e qendrës rinore dhe të rinjtë mund të vijjnë e të votojnë kur duan, atëherë deklaratat/fjalimet e tyre duhet të jenë me shkrim, në mënyrë që votuesit të mund t'i lexojnë.

Votimi duhet monitoruar për të siguruar që të rinjtë votojnë vetëm një herë. Votat duhet të numërohen nga një person neutral. Ato duhet të ruhen në mënyrë që secili prej kandidatëve të mund t'i kontrollojë. Nëse zgjedhjet janë të drejta, bordi do të realizojë detyrat e veta me efektivitet gjatë gjithë vitit. Nëse të rinjtë e respektojnë legjitimitetin e bordit, ata do të jenë të gatshëm të marrin pjesë në aktivitetet e udhëhequra prej këtij bordi dhe i gjithë aktiviteti i qendrës rinore do të jetë më efektiv.

### 3. Punonjësit e qendrës

Në qendrën rinore punojnë me kohë të plotë 2 punonjës për rininë, roli dhe përgjegjësia e të cilëve është kryesisht të mbështesin dhe të sigurojnë të gjitha lehtësitë e nevojshme për realizimin me sukses të nismave rinore. Fjala kyç në përshkrimin e punës së tyre është 'lehtësim', por në shumë raste të rriturit punonjës të qendrës shërbejnë edhe si persona burimorë të qendrës rinore duke organizuar dhe drejtuar *workshop*-e me të rinjtë sipas planeve dhe metodave për të cilat kanë rënë dakord me ta. Një tjetër funksion i rëndësishëm i punonjësve të qendrës është edhe koordinimi i punës së anëtarëve të bordit dhe mbështetja e të rinjve në procesin e hartimit, planifikimit dhe zbatimit të aktiviteteve të qendrës. Punonjësit e qendrës rinore ndajnë mes tyre përgjegjësitë për mbarëvajtjen e aktivitetit të qendrës. Njëri nga punonjësit e qendrës është përgjegjës edhe për administrimin e financës së qendrës, përgjegjësi e cila ndahet me financierin e bordit rinor.

# III. Si dhe çfarë aktivitete mund të organizohen

## I. Si organizohen aktivitetet

Në përgjithësi, procesi i organizimit të aktiviteteve mund të ndahet në tri kategori; aktivitetet mund të jenë:

- Me nismën dhe drejtimin e të rinjve
- Me nismën e të rinjve por nën mbikëqyrjen e të rriturve
- Me nismën dhe drejtimin e të rriturve

Me nismën dhe drejtimin e të rinjve: Të rinjtë kanë idenë, e zhvillojnë dhe e zbatojnë vetë atë. Kjo është situatë ideale për zbatimin e së cilës nevojitet njëfarë përvoja në planifikim, drejtim, organizim, prezantim ose disa aftësi të veçanta si p.sh në art, muzikë apo sport. Një nga qëllimet e qendrës rinore është pikërisht që të sigurojë për të rinjtë mundësinë që të fitojnë të tilla aftësi në mënyrë që të realizojnë me sukses aktivitet e tyre duke u informuar dhe duke ndarë me shoku-shokun përgjegjësitë.

Me nismën e të rinjve por nën mbikëqyrjen e të rriturve: Të rinjtë ndërmarrin vetë nismën për diçka që ata duan të mësojnë apo realizojnë, por atyre u mungojnë njohuritë, aftësitë apo burimet e nevojshme për të realizuar idenë e tyre. Për shembull, ndoshta ata kanë nevojë që të mësojnë diçka në lidhje me nisjen e një biznesi të vogël apo të kuptojnë problemet e komunitetit të cilit i përkasin. Në të tilla raste, të rinjtë punojnë të ndihmuar nga punonjësit e qendrës rinore të cilët i ndihmojnë të identifikojnë burimet ekzistuese në komunitet dhe u sigurojnë ndihmën e nevojshme për realizimin e idesë.

Me nismën dhe drejtimin e të rriturve: Ndodh shpesh që anëtarë të komunitetit (të rritur) të shprehin dëshirën dhe interesin për të ndarë me të rinjtë njohuri, aftësi apo një përvojë të caktuar (si p.sh. gatimi apo vallëzimi i një kulture tjetër apo edukimi i të rinjve me një nismë komunitare që është e përshtatshme për ta). Në raste të tilla, këta të rritur duhet ta prezantojnë idenë e tyre në bordin drejtues të të rinjve, të marrin aprovimin e saj nga bordi dhe më pas të përpiqen që të përfshijnë të rinjtë sa më shumë që të jetë e mundur në planifikimin dhe realizimin e aktivitetit rinor. Mundësisht (idealisht), kjo duhet konsideruar si rast i mirë për ngritjen e kapacitetit dhe aktiviteti duhet zhvilluar në mënyrë të tillë që të rinjtë të mund ta përsërisin atë vetë për bashkëmoshatarët e tyre.

Më poshtë përmendim disa sugjerime për realizimin e këtyre aktiviteteve.

### **Me kë të punoni**

- Përgatisni veten për një nisje të suksesshme – veçanërisht në fillim. Punoni me të rinj që tregojnë dëshirë për të punuar me ju, që janë të motivuar dhe që kanë mundësi të vijnë/shkojnë në vendin e aktivitetit. Përpiquni të bashkoni për të punuar së bashku të rinj që janë shokë ose që të paktën merren vesh me njëri-tjetrin. Nëse këta nuk janë shokë, atëherë duhet të organizoni patjetër ushtrime që ndihmojnë në krijimin e skuadrës në mënyrë që pjesëtarët e grupit të krijojnë besim tek njëri-tjetri, të shijojnë suksesin dhe të përfitojnë nga përvoja dhe aftësitë e njëri-tjetrit.
- Kërkoni rekomandime nga mësues, trajnerë etj.

### **Logjistika**

- Zbuloni mundësitë ekzistuese të komunitetit për të marrë vesh se ç'bëjnë organizatat e tjera, ç'burime ekzistojnë dhe si mund t'i përdorni ato, kush është i interesuar të bashkëpunojë me qendrën tuaj etj. Bisedoni me përfaqësues të shkollës, bibliotekës, organizatave joqeveritare, zyra të shtetit, drejtorisë arsimore dhe me mësues, trajnerë, prindër aktivë etj.
- Përpiquni të përcaktoni një orar për aktivitetet në mënyrë që të rinjtë të jenë në dijeni për orarin dhe të planifikojnë kohën e tyre siç duhet (p.sh. çdo të Premte, ora 2 pasdite, ka gjithmonë një aktivitet kulturor ose artistik etj.). Hartoni dhe prezantoni në një vend të dukshëm kalendarin e aktiviteteve me titullin dhe kohën për secilin aktivitet.
- Mbani shënim frekuentimin. Duhet të dini kush janë ata që vijnë rregullisht dhe të mbani shënim emrat e tyre, interesat që shfaqin dhe aftësitë që kanë.
- Për kohën dhe mënyrën e realizimit të aktiviteteve, mbani parasysh edhe periudhën (muajin) dhe kohën e ditës (rrethanat specifike të periudhës: vapa e verës, i ftohti apo errësira e dimrit, mungesa e elektricitetit apo orari i ujit, mundësitë e transportit etj.).

### **Përcaktimi i pritshmërive**

- Mbani qëndrim pozitiv përkundrejt arritjeve të të rinjve dhe përpiquni të përcaktoni pritshmëri sa më realiste. Mos harroni të krijoni gjasat e nevojshme për të realizuar atë që dëshironi!
- Parashikoni që gjërat mund të hanë më shumë kohë sesa kishit menduar – bëhuni të durueshëm dhe planifikoni si duhet!
- Parashikoni pritshmëritë tuaja. P.sh. për çdo mbledhje, në një bllok të veçantë, mbani shënime për diskutimet dhe vendimet më të rëndësishme. Nëse doni të bëni ndonjë bisedë miqësore me pjesëmarrësit që do të jenë prezent në mbledhje, ejani më herët, kështu do të keni mundësi të nisni dhe mbaroni takimin në kohë. Njoftoni nëse nuk mund të merrni pjesë në takim. Nëse nuk vini dot në një nga trajnimet/aktivitetet, kërkoni ndonjërit prej shokëve që t'ju tregojë se ç'ndodhi etj.
- Që në fillim, bëni të qartë kohën që nevojitet për një projekt apo aktivitet. Shpjegoni që, nëse të rinjtë bien dakord që të përfshihen në aktivitet, atëherë

ata duhet të marrin pjesë në të paktën X% të takimeve që do të organizohen (dhe ndoshta për këtë duhet t'u jepni edhe ndonjë lloj shpërblimi si p.sh. certifikatë). Por gjithashtu duhet edhe të jeni elastikë, nëse është e nevojshme, duke u ofruar atyre mënyra apo mundësi që të plotësojnë boshllëkun (që të vazhdojnë të marrin pjesë në aktivitetet apo të marrin certifikatë, pavarësisht ndonjë mungese) si dhe duke i ndihmuar që të mos largohen por të qëndrojnë në grup.

### Që procesi të funksionojë

- *Rekrutimi:* Njoftoni të rinjtë se keni nevojë të diskutoni me ta dhe përpiquini që të siguronit pjesëmarrjen e sa më shumë të rinjve dhe të inkurajoni diversitetin. Ftoni veçanërisht të rinj që janë krijuar dhe kanë ide. Ftoni gjithashtu edhe mësues, drejtues programesh rinore, prindër të interesuar, drejtues shkolle etj. në mënyrë që të gjithë grupet e interesit të jenë të informuar që në fillim të procesit dhe të mund ta ndjekin e të kontribuojnë në të. Krijoni atmosferë mikpritëse dhe nxitëse ndaj ideve të të rinjve. Bëni të qartë se ju dëshironi të punoni me ta dhe se jeni aty për të ndihmuar.
- *Grumbullimi i ideve:* Nuk është e mjaftueshme që vetëm t'i pyesni të rinjtë se çfarë duan. Kjo mund t'i bëjë ata që të ngecin vetëm në atë që tashmë dinë ta bëjnë. Jepuni atyre ide që u stimulojnë të menduarit (shikoni listën e ideve për aktivitete rinore) ose filloni bisedën duke diskutuar për pasionet që kanë, ëndrrat, qëllimet, interesat etj. dhe krijoni ide rreth këtyre. Pyetini çfarë pune do t'u pëlqente të bënin dhe çfarë aftësish e përvojash nevojiten për sukses. Pyetini se ç'aktivitete ata mendojnë se mund t'i ndihmojnë që të realizojnë qëllimet e tyre, që të zhvillojnë më tej aftësitë, që të mësojnë më shumë rreth interesave që kanë etj. Në diskutime të tilla, prezantoni edhe libra, revista, shkrime të ndryshme apo fotografi etj. pasi këto mund t'i ndihmojnë për të përfytyruar mundësi të reja. Prezantoni edhe tematika të reja që mund të jenë interesante për ta.
- *Fuqizimi i të rinjve:* Siguroni për ta ndihmën dhe mbështetjen e duhur si dhe informacion mbi burimet e nevojshme për realizimin e aktivitetit. Nxitni vetëvlerësimin e tyre duke i ndihmuar të identifikojnë dhe përdorin aftësitë e tyre për realizimin e detyrës së re. Nxitini ata që të rrezikojnë, si për shembull të bëjnë diçka që nuk e kanë bërë më parë ose të mësojnë një aftësi të re. Krijoni një mjedis që vlerëson diversitetin e ideve dhe qasjeve, pranon gabimet, nxit bashkëpunimin dhe shpërblen kontributin dhe suksesin e tyre.
- *Ndihmijini që të zbatojnë idetë e tyre:* Për secilin aktivitet zgjidhni një lider dhe ndihmijini këta gjatë procesit të hartimit, planifikimit dhe zbatimit të aktivitetit. Më parë sigurohuni që numri i të rinjve të tjerë të interesuar për këtë ide të jetë i mjaftueshëm (për efikasitet dhe ndikim).
- *Përcaktimi i pritshmëritë:* Përcaktoni ndihmën që do t'u siguronit të rinjve dhe

procesin. Për shembull: ju mund të takoheni me liderin e aktivitetit ose me një skuadër të vogël 1 deri 3 herë (në varësi të kompleksitetit të aktivitetit) për të diskutuar, për të hartuar planin dhe për t'u përgatitur. Janë të rinjtë ata që do ta drejtojnë aktivitetin, ju vetëm do ta vëzhgoni atë, do të bëni foto (nëse ata duan) dhe më pas do t'u jepni atyre përshtypjet tuaja.

- *Siguroni strukturën dhe drejtimin:* Shumë persona janë të orientuar drejt rezultatit – ata duan vetëm të realizojnë detyrën e dhënë. Në këtë rast ju duhet t'i drejtoni ata që të fokusohen edhe tek procesi, në mënyrë që të kuptojnë se çfarë janë duke bërë dhe pse po e kryejnë këtë detyrë. Zhvilloni tek ata të menduarit kritik si dhe aftësitë për vendimmarrje dhe për të punuar në skuadër. Mënyra më e mirë për t'u mësuar atyre aftësi të reja është metoda: Shpjego, Demonstr, Bëj, Kontrolllo. Shpjego çfarë duhet të bëjnë; Demonstr se si duhet bërë; Jepu mundësinë ta praktikojnë; Kontrolllo punën e tyre.
- *Hartoni dhe Planifikoni aktivitetin:* Filloni duke i pyetur se çfarë dinë, cila është përvoja që kanë, çfarë duan të mësojnë, çfarë duan të bëjnë, cilat janë burimet që kanë, kush mund t'i ndihmojë etj. Përcaktoni grupin e synuar së bashku me qëllimin dhe objektivat. Diskutoni me ta se si do ta promovojnë/njoftojnë për aktivitetin. Udhëzoni ata që të hartojnë një plan të mirë për aktivitetin – në fillim një prezantim, pastaj një ushtrim zbavitës si hapje dhe në vijim diskutim, aktivitete të ndryshme, punë në grupe etj. Është e rëndësishme që aktiviteti të jetë gjithë kohës argëtues. Në fund diskutoni me pjesëmarrësit se si mund t'i përdorin/zbatojnë këto njohuri/përvoja dhe bëni mbylljen. Për të krijuar një ide më të thelluar në lidhje me planifikimin e aktivitetit, shikoni tek Shtojcat Fletën e Planifikimit të Aktivitetit dhe Planin e Veprimit të Aktivitetit.
- *Merrni në konsideratë logjistikën:* Çfarë mjetesh ju nevojiten, a duhet të parashikoni ndonjë shpenzim, kush do të merret me këtë, cili është plani i detajuar dhe hapat, si do të organizohet dhoma e mbledhjes, në ç'orë duhet të jeni të pranishëm që pjesëmarrësit të kenë çdo gjë gati, sa kohë do t'ju nevojitet që të rregulloni çdo gjë pasi aktiviteti të ketë mbaruar, etj.
- *Monitoroni dhe vlerësoni aktivitetin:* Mendoni gjithmonë për qëllimin dhe objektivat e aktivitetit. Si do të mund të gjykoni nëse i keni realizuar objektivat? Mendoni se çfarë do ta bënte aktivitetin të suksesshëm dhe në ç'mënyrë do të mund të vërtetoni se aktiviteti ishte i suksesshëm (cilët janë treguesit dhe si do ta matni rezultatin). Sigurohuni që për këtë të merrni përshtypjet e pjesëmarrësve (feedback) për aktivitetin nëpërmjet fletë-vlerësimeve apo nëpërmjet një diskutimi të shkurtër në fund të aktivitetit. Nëse ju nevojiten ide apo udhëzime në lidhje me aktivitetet për Monitorimin dhe Vlerësimin, shikoni tek Shtojcat.
- *Merrni në konsideratë problemet dhe shqetësimet:* Zbuloni cilat mund të jenë disa nga problemet që mund të dalin dhe kujdesuni që t'i kapërceni ato. Shqyrtoni të papriturat dhe merrni masa për plane rezervë (p.sh. po sikur të

vijnë më shumë njerëz apo vetëm 2, po sikur dhoma e mbledhjes të jetë e mbyllur, po sikur të ikin dritat, po sikur koha të jetë e keqe dhe të bjerë shi, po sikur fëmijët/të rinjtë pjesëmarrës të jenë rrëmujaxhinj apo të bëjë tmerrësisht vapë? E të tjera).

- *Praktikë, sa më shumë praktikë!* Jepuni mundësi të rinjve të ushtrohen duke folur me zë të plotë, me besim në vetvete dhe pa letër përpara. U jepni atyre mundësinë të ushtrohen në përgjigje të pyetjeve sfiduese, të pranojnë komentet dhe pyetjet, të përdorin mjete vizuale etj. Vazhdoni të punoni me ta derisa të kenë një plan të detajuar për aktivitetin e të ndihen gati dhe me besim në vetvete.
- *Realizimi i aktivitetit:* Tani të rinjtë janë gati të “ekzekutojnë” planin e tyre. Qëndroni me ta për të ofruar mbështetje dhe më pas përshtypje (feedback). Bëni çmos që të mos ndërhyri ndërsa të rinjtë përpiqen të zgjidhin një situatë. Ndërhyri vetëm nëse është vërtet e nevojshme. Kjo do t’u japë atyre mundësinë që t’ia dalin mbanë vetë. Ndihejini duke hartuar liste-prezencën dhe bëni fotografi. Në fund të aktivitetit, kërkoni nga pjesëmarrësit që t’ju japin përshtypjet e tyre për aktivitetin.
- *Raportimi pas aktivitetit:* Mbas aktivitetit bëni një takim me të gjithë ata që e planifikuan dhe e realizuan atë. Përdorni pyetje që nxitin reflektimin në mënyrë që ata të shprehin përshtypjet e tyre për aktivitetin. Disa nga pyetjet mund të jenë: çfarë shkoi mirë, çfarë do të bëni ndryshe në aktivitetin tjetër, çfarë mësuat nga ky aktivitet, a mund ta kishit shmangur ose anashkaluar një problem të shfaqur, a mund ta trajtonit atë ndryshe, çfarë ishte më e thjeshtë dhe çfarë më e vështirë nga sa prisnit, si u ndjetë, po tani si ndiheni, si do ta shfrytëzoni përvojën e fituar kur t’ju jepet mundësia apo në një situatë tjetër, çfarë rekomandimesh mund të jepni për dikë tjetër që mund të përsërisë të njëjtin aktivitet etj.
- *U jepni përshtypjet tuaja (feedback):* Jepuni feedback specifik për sjelljen dhe interpretimin/efektshmërinë e tyre. Jepni në fillim sa më shumë përshtypje pozitive dhe pastaj përmendni edhe 1 – 3 drejtime që kanë nevojë për përmirësim. Fokusoni drejtime kryesore si përgatitja, vetëbesimi, menaxhimi i pjesëmarrësve (i grupit), aftësitë komunikuese (verbale dhe jo verbale), rrjedhshmëria, procesi, rezultati, aftësia për t’u përballur me sfidat, ndërveprimi me të tjerët etj. Shembuj pozitivë: “Ju bëtë një punë të shkëlqyer me prezantimin e ditës së sotme. Dukeshit shumë të sigurt në vetvete. Ishte fare e dukshme që ishit përgatitur dhe organizuar siç duhet. E shpjeguat fare qartë të gjithë materialin. Puna e palodhur që keni bërë e dha rezultatin – ju lumtë!” Shembuj për të shprehur drejtimet që kanë nevojë për zhvillim: “Personat në fund të dhomës e patën të vështirë të lexonin shënimet në tabelë pasi shkronjat ishin shumë të vogla. Nëse i bëni shkronjat më të mëdha, rreth 4 cm, do të jeni të sigurt që të gjithë do të lexojnë çfarë keni shkruar.”

- *Dokumentimi*: Sigurohuni që vetë të rinjtë të dokumentojnë të gjithë procesin si dhe rezultatet e aktivitetit. Kjo do t'i ndihmojë ata që të mendohen më mirë kur planifikojnë. Dokumentimi është gjithashtu një aftësi shumë e rëndësishme prej të cilës do të përfitojnë edhe të tjerët që do të lexojnë për aktivitetin dhe do të mësojnë nga suksesi dhe rekomandimet. Për të krijuar një ide më të thelluar në lidhje me dokumentimin e aktivitetit, shikoni tek Shtojcat Fletën e Raportimit të Aktivitetit.
- *Shprehni vlerësimin ndaj tyre dhe festoni suksesin!* Prezantoni publikisht përshtypjet tuaja pozitive dhe shprehini personit në veçanti përshtypjet dobiprurëse apo kritikën pozitive. Në fund të çdo aktiviteti falënderojini për vëmendjen, pjesëmarrjen, punën e palodhur, idetë etj. Theksoni dhe vlerësoni kontributin e tyre dhe jepni përshtypje pozitive në mënyrë që ata të hapen dhe të ndajnë me ju perceptimet e tyre (ky është një koment me shumë vlerë, kjo është një pyetje me vend etj.). Organizoni aktivitete me qëllim njohjen e meritës së tyre, publikoni suksesin dhe organizoni ekspozitë me fotografi. Të rinjtë do të gëzohen pa masë nga kjo njohje e meritës dhe komuniteti ka nevojë të marrë vesh në lidhje me kontributin që japin të rinjtë. Është e rëndësishme që të rinjve t'u jepet mundësia të gëzojnë frytet e punës së tyre të palodhur.

Për të gjithë ju që punoni me të rinjtë, **MBANI MEND!** Mënyra se si sillen njerëzit është në përputhje me përvojën e tyre jetësore. Të rinjtë, sikurse të gjithë njerëzit, janë produkt i mjedisit përkatës. Nëse ata bëjnë diçka që ju bën të ndiheni të irrituar, mos u mërzitni, përkundrazi, përpiquni që t'u siguron mundësi për përvoja të reja dhe përmirësoni mjedisin e tyre. Bëhuni model i mirë! Bëhuni burim frymëzimi! Ju keni në dorë një mundësi të shkëlqyer që ditë pas dite të siguron një ndikim pozitiv tek liderat e gjeneratës së ardhshme. Udhëhiqini ata që të mësojnë mënyra të reja komunikimi, të menduari, sjelljeje, të ëndërruari. Ndihmohuni ata të shohin dhe krijojnë mundësi të reja për veten dhe jetën e tyre. Përpiquni të jeni për ta personi që do ta mbajnë mend dhe rikujtojnë me kënaqësi si dikush që i udhëhoqi dhe u shërbeu si frymëzim për jetën.

## 2. Ide për aktivitete me dhe për të rinjtë

Idetë e përmendura më poshtë janë vetëm disa prej aktiviteteve të organizuara nga të rinjtë në qendrën rinore<sup>9</sup>. Të gjitha këto ide janë shprehur dhe kanë nisur të zbatohen nga vetë të rinjtë. Qëllimi kryesor i këtyre aktiviteteve është informimi dhe pajisja e të rinjve me njohuri, shprehje dhe aftësi për jetën. Për realizimin e

---

<sup>9</sup> Save the Children në bashkëpunim me Bashkinë e Kuçovës.

disa prej këtyre ideve të rinjtë punojnë të pavarur dhe të organizuar në skuadra (anëtarët e bordit rinor), ndërsa për disa të tjera ata punojnë së bashku me punonjësit e qendrës rinore. Secila nga idetë e renditura më poshtë mund të organizohet si një aktivitet që ndodh vetëm një herë, si një aktivitet që ndodh periodikisht (si p.sh. të martën apo të mërkurën e parë të çdo muaji) ose si një program (çdo ditë, për një javë të tërë etj.). Për secilin nga aktivitetet mund të përcaktohet edhe grupmosha, për të krijuar mundësi zgjedhjeje për të gjitha moshat. Të rriturit (të punësuarit në qendër) mund të drejtojnë sesionet ose mund të punojnë me të rinjtë në mënyrë individuale apo në skuadra të vogla për t'i përgatitur ata që t'i drejtojnë vetë sesionet.

- **Teatër** –Të vësh në skenë një shfaqje është një mundësi e shkëlqyer për t'u shprehur në lidhje me një temë/problem<sup>10</sup> të caktuar si dhe për të krijuar mes të rinjve frymën e skuadrës. Kjo kërkon padyshim aftësi dhe është një mënyrë shumë efektive për të përfshirë persona të ndryshëm në lojë. Shfaqja gjithashtu mund të luhet për publikun dhe mund të shërbejë edhe si mundësi për ngritjen e fondeve. Për të ndihmuar të rinjtë që të përgatisin skenarin, kostumet, skenografinë, marionetat, kërcimin, muzikën, dritat etj., përdorni burimet ekzistuese të komunitetit. Trajtimi i temave të ndryshme i ndihmon të rinjtë të shprehin problemet e tyre dhe njëkohësisht të informojnë bashkëmoshatarët në lidhje me to.
- **Gatimi** – gatimi dhe ngrënia e një vakti së bashku është një mundësi shumë e mirë për krijimin dhe argëtimin e grupit. Ju mund të ftoni kuzhinierë nga ndonjë restorant, studentë të shkollës së kuzhinës, vizitorë nga kultura dhe rajone të ndryshme ose këdo që mund të gatuajë diçka të shijshme dhe që mund t'u mësojë të rinjve se si të përgatisin gatime tradicionale nga vende të tjera duke përdorur përbërës që gjenden në treg. Gjithashtu, edhe të rinjtë mund të gatuajnë ato gjëra që atyre u pëlqejnë. Një tjetër mundësi është t'u sigurosh receta gatimi dhe fotografi dhe t'i lesh ta përgatisin ushqimin vetë.
- **Sipërmarrja/Biznesi** – Njohuritë dhe aftësitë bazë të biznesit do t'i përgatisin të rinjtë si konsumatorë dhe lidera më të mirë. Mësojuni atyre të mendojnë në lidhje me nevojat e konsumatorit dhe produktet/shërbimet e tregut, të hartojnë dhe paketojnë një produkt, të ngrenë fonde, të shesin produktet/shërbimet e tyre, të menaxhojnë paratë etj. Krijoni mundësinë që ata të shesin një prodhim ose shërbim tyrin, edhe sikur për pak orë. Kjo

<sup>10</sup> Temat e përzgjedhura nga të rinjtë janë të lidhura me jetën e tyre të përditshme, shqetësimet, problemet, vështirësitë e mundshme. Të tilla janë tema si droga, dhuna, marrëdhëniet mes tyre dhe me të rriturit etj.

mund të jetë një panair me ëmbëlsira apo punime dore të tyre, larje makinash, ndonjë punë e thjeshtë etj. Fitimet nga aktivitete të tilla mund të përdoren si fonde për qendrën rinore.

- **Art dhe punëdore** – Puna krijuese stimulon imagjinatën e njeriut dhe është argëtuese. Krijoni mundësinë që të rinjtë të shprehin talentin e tyre duke u përfshirë në një shumëllojshmëri aktivitete artistike si qepje dhe qëndisje, fotografi, vizatim, butafori, kompjutera, krijime letrare, media etj. Ndoshta me to ju mund të hapni edhe ekspozita nëpërmjet të cilave të rinjtë tregojnë talentin apo krijimet e tyre ose të organizoni konkurse.
- **Çështjet gjinore** – Eksplorimi i situatës dhe çështjeve që lidhen me gjininë mund të jetë një tjetër aktivitet që i ndihmon, fuqizon dhe informon të rinjtë dhe që njëkohësisht nxit debat energjik mes tyre. Në të tilla aktivitete mund të diskutoni rolet gjinore – si influencohen këto nga kultura, si përvetësohen apo mund të ndryshojnë, si influencojnë ato mënyrën tonë të menduarit, si nuk duhet të lejojmë që gjinia të na kufizojë në jetë etj.
- **Mjedisi/ Klubi i natyralistëve** – Mbrojtja e mjedisit është shumë e rëndësishme sepse vetëm kështu gjeneratat e ardhshme do të shijojnë burimet e natyrës. Mësojini të rinjtë të grumbullojnë plehrat, të riciklojnë mbeturinat apo të kenë njohuri për mjedisin e tyre rrethues dhe problemet që ndikojnë në të. Organizoni marshime në natyrë, kamping, diskutoni me ta për natyrën, organizoni me ta aktivitete të vogla komunitare për pastrimin e mjedisit rrethues, fushata ndërgjegjësimi për mbrojtjen e mjedisit etj.
- **Kopshtari** – Kopshtaria është një tjetër mënyrë e suksesshme që jep rezultate të prekshme dhe u mëson të rinjve aftësi për jetën si planifikimi, përkujdesja, durimi, besimi, ndarja e përgjegjësisë etj. Ju mund të krijoni një serë të vogël<sup>11</sup> lulesh dhe t'u mësoni të rinjve se si të zgjedhin bimët, të përpunojnë tokën, të mbjellin, krasitin, kultivojnë etj. Produktet e këtij aktiviteti mund t'i përdorni për grumbullim fondesh ose për të zbukuruar mjedisin përreth.
- **Shëndeti** – Njohuritë për shëndetin dhe mirërritjen janë shumë të rëndësishme për një jetë të mirë dhe cilësore. Të rinjtë marrin njohuri bazë mbi ndihmën e shpejtë, të ushqyerit, zgjedhjen e ushqimeve të shëndetshme,

---

<sup>11</sup> Ky është një aktivitet që, përveç të tjerash, shërben edhe për gjenerimin e fondeve të cilat qendra rinore mund t'i përdorë për aktivitete të tjera.

higjienën për gojën, mënyrat e shmangies së stresit, shëndetin seksual, sjelljet e rrezikshme etj.

- **Fizkulturë** – Ushtrimet janë shumë të rëndësishme për një trup të shëndetshëm. Mësojini të rinjtë si të hanë e të pinë për të qenë aktivë fizikisht dhe çfarë ushtrimesh të bëjnë për të pasur një trup të shëndetshëm. Shembuj ushtrimesh që janë zhvilluar në qendrën rinore janë ato të programit të aerobisë/jogës/arteve marciale, ato të programit të vrapit apo ecjes së shpejtë, lojërat me dorë, futbollit apo edhe lojëra të reja. Herë pas here organizoni kampionate të ndryshme (p.sh. aerobie, futbollit apo lojërash me dorë), olimpiada argëtuese me aktivitete të vërteta ose zbavitëse, kros me përfshirjen e komunitetit (5 km) etj.
- **Klubet ndërkombëtare** – Të rinjtë mësojnë për kultura të tjera dhe kjo i ndihmon ata të zgjerojnë njohuritë dhe të kuptojnë e pranojnë diversitetin. Për shembull, të rinjtë përfshihen për një javë në studimin e një kulture të caktuar, mësojnë disa fjalë apo përkrahjet të gjuhës përkatëse, përgatisin ushqime tipike, studiojnë historinë, përgatisin albume me fotografi, ftojnë persona që kanë më shumë njohuri për këtë kulturë ose i përkasin asaj etj. Gjithashtu të rinjtë kërkojnë dhe zbulojnë të reja për letërsinë e një vendi të caktuar, filmat, kulturën popullore, muzikën, sportin, tendencat, stilin e jetës etj. Të gjitha ditët duhet/mund të shoqërohen me aktivitete tipike të kësaj kulture.
- **Gjuhë të huaja** – Mësimi i gjuhëve të huaja u jep të rinjve më shumë mundësi në jetë. Anglishtja konsiderohet një gjuhë ndërkombëtare dhe ndoshta për këtë është edhe shumë popullore; por, në qendrën rinore janë organizuar edhe kurse të gjuhëve të vendeve fqinje, pasi këto janë të rëndësishme për vendin dhe ekonominë globale. Shumica e të rinjve pjesëmarrës në aktivitetin e qendrës rinore nuk i kanë mundësitë ekonomike për të paguar mësimet private. Për këtë arsye, ofrimi i kurseve të gjuhës së huaj i afron ata në qendër. Për sa i përket mësuesve të gjuhës, së pari bëni një kërkim të mundësive që mund të ekzistojnë në komunitet si vullnetarët përfaqësues të ndonjë OJF-je etj. P.sh. në qendrën rinore në Kuçovë, realizimi i këtyre kurseve është bërë i mundur nëpërmjet përfshirjes së disa vullnetarëve të huaj që punojnë në këtë komunitet dhe që u treguan të gatshëm të dhurojnë kohën dhe njohuritë e tyre për kurset e gjuhës së huaj.
- **Mbështetja shkollore** – Ky është një nga aktivitetet që është nxitur dhe mbështetur gjerësisht nga të rinjtë. Një aktivitet i tillë, përveç se u jep mundësi të rinjve të ftojnë aftësi “mësimdhënieje”, krijon dhe nxit bashkëpunimin

midis nxënësve me prejardhje të ndryshme dhe me nivele të ndryshme njohurish shkollore. Kështu, në qendër, nxënës me arritje të mira në mësim ofrojnë vullnetarisht ndihmën e tyre për bashkëmohatarët/shokët që kanë vështirësi në lëndë të caktuara. Një aktivitet i tillë i ndihmon të rinjtë të thellojnë njohuritë e tyre dhe ka përforcuar frymën e bashkëpunimit midis të rinjve e i ka ndihmuar ata të krijojnë dhe forcojnë miqësi të reja. Gjithashtu, të rinjtë ndihmojnë jo vetëm bashkëmohatarët por edhe fëmijët e vegjël për të bërë detyrat. Mbështetja shkollore bëhet duke ndjekur një orar të përcaktuar dhe ofrohet në grupe të vogla apo individualisht; por, në raste konsultimesh për një lëndë të veçantë, mund të bëhet edhe si forum i hapur. Nxitini nxënësit që vijnë në konsultime që të ndihmojnë edhe të tjerët që nuk janë prezent.

- **Aktivite për fuqizimin e skuadrës** – Nxitja e bashkëpunimit dhe e punës në grup. Fokus i veçantë i është vënë aktiviteteve që fuqizojnë punën e grupit dhe bashkëpunimin si një nga aftësitë më të vlefshme për jetën. Organizoni sa më shumë aktivitete që u japin mundësinë të rinjve të punojnë së bashku e të gjejnë bashkërisht zgjidhje për situata sfiduese. Si shembuj mund të merrni si situata/lojëra argëtuese ashtu edhe detyra serioze. Për aktivitete të tilla ka burime të shumta si libra, manuale por edhe materiale në internet.
- **Programi i Lidershipit (seri trajnimesh)** – Ky program përfshin mësimin dhe diskutimin e aftësive drejtuese nëpërmjet aktiviteteve që demonstrojnë aftësitë e nevojshme dhe rëndësinë e lidershipit. Disa nga temat përfshijnë aftësitë komunikuese, zgjidhjen e problemeve, të menduarit kritik, fjalimin në publik, punën në skuadër etj. Për ta bërë programin të fokusuar, ndihmohini të rinjtë që të identifikojnë një problem të komunitetit të tyre që ata duan ta ndryshojnë dhe të organizojnë projekte/shërbime komunitare nëpërmjet të cilave të vënë në zbatim aftësitë e tyre drejtuese.
- **Jam qytetar** – Qëllimi i aktivitetit është të promovojë pjesëmarrjen e të rinjve në vendimmarrjen lokale si dhe të inkurajojë ndjenjën e përgjegjësisë ndaj komunitetit përkatës. Të rinjtë mësojnë se si funksionon dhe drejtohet qeverisja lokale dhe ndërgjegjësohen për faktin se përfshirja e tyre në të i bën ata qytetarë të denjë. Ndhmohini ata të identifikojnë dhe t'i prezantojnë strukturave të qeverisjes lokale një çështje shqetësuese për ta (fëmijët dhe rininë) si dhe të ndjekin procesin e aprovimit dhe zbatimit të saj. Ky është një aktivitet sa i rëndësishëm aq edhe delikat; ndaj, që të siguron pjesëmarrje kuptimplotë të të rinjve në komunitet, ndihmohini ata të kuptojnë rolin e tyre vendimtar dhe nevojën për të qenë të konsultuar për çdo vendimmarrje

që ka të bëjë më ta. Bashkëpunoni me këdo që është aleat i juaj në komunitet. Këta mund të jenë përfaqësues të OJF-ve apo të organizatave të tjera lokale si shkolla, drejtoria arsimore etj. Nxitni vazhdimisht ndjenjën e vullnetarizmit duke krijuar për të rinjtë mundësi konkrete për veprim.

- **Shfaqje për më të talentuarit** – Siguroni për të rinjtë mundësi për të shprehur dhe shfaqur tek të tjerët talentet dhe aftësitë e tyre të veçanta. Kjo do t'i ndihmojë ata që të fitojnë përvojë në prezantimin publik. Shembuj të kësaj mund të jenë mundësi për të shfaqur talentin e tyre për të bërë humor, talentin artistik apo edhe performanca serioze.
- **Çfarë u nevojitet të rinjve që të jenë të suksesshëm** – Instituti i kërkimit “Search Institute®” ka treguar se të rinjve u nevojiten 40 vlera/cilësi që të jenë të suksesshëm. Këto përfshijnë si vlera/cilësi të jashtme (ku futen nevoja për mbështetje dhe fuqizim, kufizimet dhe pritshmëritë e tyre, përdorimi i kohës me efikasitet etj.) ashtu edhe të brendshme (ku futen angazhimi për të mësuar, vlerat pozitive, kompetenca sociale, identiteti pozitiv etj.). Bëni një hulumtim për të kuptuar se cilat cilësi/vlera të rinjtë kanë nevojë të forcojnë apo zhvillojnë dhe organizoni aktivitete për këtë qëllim.
- **Aftësitë për të shkruar mirë** – Aftësia për të shkruar mirë është tejet e rëndësishme për të pasur sukses si në shkollë edhe në punë. Mësojuni të rinjve stile të ndryshme të shkruari – krijime (hartim, ese, reportazh etj.), shkrim biznesi, poezi etj. Me to mund të organizoni edhe konkurse apo të përgatisni një libërth me histori të shkurtra.
- **Gazeta rinore** – Pjesëtarët e kursit për aftësim në të shkruar mund të hartojnë edhe gazetën e qendrës rinore ose të shkruajnë për gazetën lokale shkrime për rininë. Të rinjtë mund të mësojnë për gazetarinë, faqosjen, grafikën, fotografinë, hartimin e njoftimeve etj. Gazeta edhe mund të shitet në mënyrë që të grumbullohen fonde për projekte të tjera rinore.
- **Aftësitë prezantuese** – Për të bërë prezantime të mira nevojitet përvojë. Krijoni mundësi që të rinjtë të zhvillojnë aftësitë e tyre prezantuese duke i ushtruar ato në prezantime, fjalime të shkurtra dhe debate mbi tema interesante për ta.
- **Aftësitë lehtësuese** – Drejtimi i një trajnimit ose i një mbledhjeje kërkon aftësi të mira lehtësuese. Organizoni për të rinjtë *workshop*-e që të mësojnë se si t'i përdorin këto aftësi dhe si të organizojnë takime dhe mbledhje efektive me pjesëmarrjen aktive të të gjithëve.

- **Diversiteti** – Duke u fokusuar në vlerën e diversitetit dhe respektimit të tij, ju do t'i inkurajoni të rinjtë e kulturave dhe etnive të ndryshme që të bashkëveprojnë me njëri-tjetrin në mënyrë pozitive duke minimizuar diskriminimin dhe stereotipat. Organizoni aktivitete që i ndihmojnë të rinjtë të pranojnë aspektet pozitive të skuadrave me ide dhe përbërje të shumëllojshme si dhe të trajtojnë siç duhet situatat e konfliktit (nëse ndodhin).
- **Aftësitë për jetën** – Një shumicë aftësish themelore për jetën u siguron të rinjve një jetë të suksesshme dhe të mbarë. Bëni një vlerësim të nevojave që ata kanë për përmirësim apo zhvillim dhe organizoni seanca trajnimi me tema si përcaktimi i qëllimeve, vendimmarrja, vlerat, të qenët i/e drejtpërdrejtë, planifikimi dhe organizimi, menaxhimi i kohës etj.
- **Klubi i librit / Filmit** – Promovoni leximin e librave dhe shikimin e filmave jo vetëm si argëtim por edhe si aktivitet edukues dhe social. Jepini një grupi të rinjsh të lexojnë të njëjtin libër ose të shohin së bashku një film dhe më pas diskutoni bashkërisht. Drejtuesit e grupit përgatisin një listë me pyetje dhe drejtojnë diskutimin duke u përqendruar tek mësimet e nxjerra dhe si mund t'i aplikojnë ato në jetën e tyre. Zgjidhni libra/filma me interes kulturor, historik ose që janë shembuj të mirë për jetën.
- **Planifikimi i karrierës** – Shumë të rinj që ndjekin shkollën e mesme fillojnë të mendojnë se ç'do të bëjnë pasi të mbarojnë shkollën. Ndhijmojini të rinjtë që të zbulojnë jo vetëm interesat por edhe aftësitë dhe pikat e tyre të forta pasi kështu do t'i ndihmoni të marrin një vendim mbi çfarë duan të bëjnë pasi të mbarojnë shkollën e mesme. Përdorni ide nga libra të ndryshëm apo organizoni edhe aktivitete ose programe punësimi afatshkurtër (në verë). Mund të organizoni edhe sisteme “binjakëzimi” ku një i rritur punon për pak kohë (gjatë verës) bashkë me një të ri (nëse i rrituri ka një zanat që i intereson të riut).
- **Muzikë / grup vallëzimi** – Provoni kënaqësinë e muzikës dhe kërcimit si një aktivitet i shkëlqyer për forcimin e komunitetit. Krijoni mundësi që të rinjtë të mësojnë të luajnë vegla muzikore, të krijojnë vetë muzikë, të japin shfaqje për bashkëmoshatarët etj. Jepuni mundësi të praktikojnë stile të ndryshme kërcimi. Më pas organizoni koncerte me muzikë dhe vallëzime të ndryshme të krijuara nga vetë të rinjtë. Kjo është vërtet argëtuese.
- **Çështje sociale** – Krijoni mundësi që të rinjtë të angazhohen në diskutime të temave aktuale sociale si martesat dhe shtatzënitë e hershme, droga dhe alkooli, edukimi seksual, të drejtat njerëzore, demokracia, dhuna në familje,

trafikimi i qenieve njerëzore etj. Për tema specifike ftoni edhe përfaqësues nga organizata që punojnë në fusha të tilla dhe diskutoni me të rinjtë se si mund të ndihmojnë ata për trajtimin e këtyre çështjeve në komunitetin e tyre.

- **Marrëdhëniet dhe komunikimi** – Marrëdhëniet e mira me prindërit, mësuesit, shokët, bashkëpunëtorët apo klientët e kanë themelin në aftësitë komunikuese. Praktikoni dhe zhvilloni aftësitë komunikuese (dëgjimin, leximin, shkrimin, të folurit, bisedën ballë për ballë, të folurit në publik). Organizoni aktivitete ku të rinjtë të mund të përdorin aftësitë komunikuese për të forcuar marrëdhëniet me të tjerët.
- **Klubi i lojërave/shahut** – Ofroni edhe lojëra të qeta e në grupe të vogla. Të tilla mund të jenë lojërat si shahu ose dama të cilat mund t'i organizoni javë për javë dhe, nëse të rinjtë janë të interesuar, mund të organizoni edhe kampionat.
- **Skuadrat Sportive** – Edhe nëpërmjet sportit përvetësohen mjaft aftësi për jetën (puna në ekip, stërvitja, planifikimi, fitorja dhe humbja, loja e ndershme, korrektësia dhe natyra sportive etj.). Të rinjtë që janë të interesuar të praktikojnë sport mund të organizohen në skuadra futbollit, basketbollit ose volejbollit dhe të stërviten çdo javë, të luajnë apo të organizojnë kampionate.
- **Bëni partneritet me organizata të tjera** – Bota është e gjitha e ndërlidhur. Ne të gjithë kemi nevojë që të mbështetemi tek të tjerët për punën. Jepuni të rinjve mundësinë që, për të realizuar projekte komunitare apo festa të ndryshme, të bashkëpunojnë me organizata të tjera që veprojnë në komunitet si shoqata rome, të gruas, profesionistësh, sportive etj.

# Shtojca I: - Shembuj të dobishëm për organizimin dhe funksionimin e qendrës rinore

## Shembull i rendit të ditës për mbledhjen e Bordit Rinor

13 Dhjetor 2007

13:00 – 14:30

Qendra Rinore Kuçovë

### Rishikimi dhe aprovimi i rendit të ditës:

Presidenti harton rendin e ditës përpara së të fillojë mbledhja. Secili prej anëtarëve e lexon atë dhe sugjeron ndonjë ndryshim (nëse ka).

### Njoftimet më të rëndësishme:

Përpara se të fillojë mbledhja, presidenti njofton nëse ka ndonjë ndodhi apo lajmërim të veçantë si p.sh. nëse kanë ndonjë të ftuar, nëse janë bërë ndryshime në planin mujor të qendrës apo nëse ka ndonjë ndryshim në bord.

### Rishikimi i raportit të mbledhjes së mëparshme:

Diskutohen ato veprimtari apo detyra që janë përcaktuar në mbledhjen e mëparshme dhe raportohet/shqyrtohet arritja e tyre.

### Raporti i Presidentit:

Presidenti drejton mbledhjen e bordit. Ai raporton për aktivitetin përfaqësues që ka kryer gjatë periudhës në fjalë. Ky mund të përfshijë takime me anëtarë të komunitetit ose me të rinj nga shkollat apo qeveritë e nxënësve, probleme apo ide të ndryshme si dhe përshtypjet apo rezultatet e takimeve lidhur me të cilat ai ka nevojë të marrë opinionin apo pëlqimin e bordit.

### Raporti i Financierit:

Financieri prezanton çdo gjë që ka lidhje me gjendjen financiare të qendrës që nga mbledhja e fundit. Ai mban shënim shpenzimet dhe harton raport në mënyrë që secili prej anëtarëve të bordit të dijë se si dhe për çfarë janë shpenzuar paratë.

### Raporti nga Drejtuesi i Qendrës<sup>12</sup>:

Drejtuesi i qendrës i prezanton bordit çdo informacion që anëtarët e tij kanë nevojë të dinë në lidhje me idetë, burimet dhe mundësitë e reja të prezantuara, takimet me autoritetin përgjegjës për Qendrën Rinore<sup>13</sup> apo çdo njoftim tjetër me rëndësi.

---

<sup>12</sup> I rritur që punon në qendrën rinore me pagesë

<sup>13</sup> Në këtë rast Bashkinë

### **Raportimet e skuadrave (grupeve të punës):**

*Një përfaqësues nga secila skuadër prezanton shkurtimisht aktivitetin dhe progresin e punës së skuadrës së tij që nga koha e mbledhjes së fundit.*

### **Diskutime të tjera:**

- Çështje të mbartura nga mbledhjet e mëparshme
  - Çdo gjë që është nisur por nuk është finalizuar akoma
- Çështje të reja
  - Prezantimi, nga vetë anëtarët e bordit ose nga të rinjtë e tjerë, i ndonjë ideje të re të cilën ata e transmetojnë në bord. Kjo mund të jetë një ide për një projekt/aktivitet të ri apo për krijimin e një skuadre të re.

### **Vlerësimi i takimit:**

*Pas ÇDO MBLEDHJEJE bordi duhet të shpenzojë pak minuta për të diskutuar se çfarë shkon mirë dhe çfarë mund të përmirësohet në këto mbledhje. Nëse ekzistojnë probleme që kanë të bëjnë me komunikimin ose ndonjë mospajtim të mundshëm, këto duhet të diskutohen patjetër në mënyrë që të sqarohen dhe shmangen përsëritjet në të ardhmen.*

### **Përcaktimi i takimit të ardhshëm:**

*Data dhe ora e takimit të ardhshëm duhet të përcaktohen dhe të mbahen shënim, pasi të jetë rënë dakord për to, po atë ditë dhe jo një ditë përpara këtij takimi të ardhshëm.*

### **Veprimtari për t'u kryer:**

*Kjo është një nga pjesët më të rëndësishme të mbledhjes. Sekretari mban shënim çdo veprimtari që u vendos për t'u kryer nga anëtarët e bordit dhe në fund të mbledhjes i rikujton ato. Në mbledhjen e ardhshme, këto shënime do të përdoren për të rishikuar realizimin e veprimtarive të cilat u ra dakord se do të kryheshin nga anëtarët.*

## Shembull i protokollit të mbledhjes së bordit rinor

Qendra Rinore Kuçovë  
13 Dhjetor 2007  
13:00 – 14:30

### Anëtarë të bordit:

Prezent: Agimi, Diana, Mira, Tomi, Ledia, Xhani, Edmiri, Ervisi,  
Mungon: Ornela

Pjesëmarrës të tjerë prezent: Sokoli, Altini

### Hyrje:

- Agimi, zëvendëspresident i bordit, fillon mbledhjen në orën 13:05 dhe prezanton programin
- Programi aprovohet nga bordi

### Njoftime:

- Presidenti është i sëmurë dhe nuk merr dot pjesë në mbledhje. Në vend të tij mbledhja drejtohet nga zv/presidenti
- Qendra Rinore do të jetë e mbyllur të Hënën sepse punonjësit do të shkojnë në Tiranë për një mbledhje.
- Për debatin që do të organizohet të enjten për drogën, sot mbas mbledhjes duhen shpërndarë posterat dhe njoftimet.

### Raportimi bëhet nga Agimi pasi presidenti mungon:

- Presidenti i ka kërkuar kryetarit të bashkisë që të marrë pjesë në një nga mbledhjet e bordit dhe ai e ka pranuar ftesën dhe do të marrë pjesë në mbledhjen ardhshme.

### Raportimi i Dianës, financieres së bordit:

- Përgjegjësi i bibliotekës ka hartuar një listë me 15 tituj librash që janë me interes për shumë të rinj. Për blerjen e tyre nevojiten 9000 lekë. Financierja njofton se, nga buxheti i muajit që shkoi, ata kanë shpenzuar vetëm 3000 lekë dhe për këtë arsye mendon se mund t'i blejnë këto libra. Bordi aprovon blerjen e titujve dhe ia kalon kërkesën për aprovim administratorit.

### Raportimi i Mirës, koordinatores (punonjëse e qendrës):

- Përfaqësues nga Save the Children në Tiranë do të vijin javën tjetër në qendër dhe dëshirojnë të takohen me disa nga anëtarët e bordit. Mira kërkon që të paktën 5 nga anëtarët e bordit të takohen me ta; 6 prej tyre pohuan se kanë

mundësi të vijë në takim. Mira do t'i njoftojë këta të gjashtë për ditën dhe orën e saktë.

*Raportimi i Tomit, drejtuesit të skuadrës së Bibliotekës:*

- Skuadra për mbarëvajtjen e Bibliotekës ka paraqitur një listë me 15 libra të rinj për bibliotekën. Ata kanë marrë listën e çmimeve dhe kanë kontrolluar nëse ekzistojnë në libraritë e qytetit. Kërkesa për blerjen e librave aprovohet nga bordi dhe i jepet administratorit për blerje.

*Raportimi i Ledit, drejtuesit të skuadrës së Sportit dhe Krijimtarive:*

- Gjatë javës së shkuar, skuadra ka realizuar në fushën e Qendrës Rinore një kampionat të vogël futbollit. Në të morën pjesë 60 të rinj, kryesisht djem. Raporti i vlerësimit të këtij aktiviteti iu dha koordinatores së qendrës. Projekti i tyre i ardhshëm është kampionati 2-javor i basketbollit që do të organizohet javës që vjen. Plani për këtë projekt aprovohet nga bordi.

*Raportimi i Xhanit, drejtuesit të skuadrës së aktivitetit jashtë qendrës:*

- Si aktivitet të parë, skuadra e aktivitetit jashtë qendrës rinore<sup>14</sup> ka planifikuar të organizojë për prindërit, ditën e shtunë, një aktivitet të quajtur “dyert hapur”. Xhani vë në dukje se qendra është e mbyllur pasditeve. Mira thotë se ajo është e gatshme që të qëndrojë një ditë deri vonë për të organizuar “dyert hapur”. Xhani nuk jep detaje për aktivitetin pasi skuadra ende është duke u përgatitur.

*Punë të mbetura pezull nga mbledhja që kaloi:*

- Në mbledhjen e fundit, Edmiri tha se Kryetari i Bashkisë kishte shprehur dëshirën të takohej me ta. Presidenti u takua me kryetarin dhe ky do të vijë për takim në mbledhjen e ardhshme.
- Në mbledhjen e fundit është diskutuar shpërndarja e ushqimeve për disa familje të varfra nga Kryqi i Kuq. Përfaqësuesit e Kryqit të Kuq nuk kanë punonjës dhe kanë kërkuar ndihmën e të rinjve të qendrës rinore për shpërndarjen. Diana, financierja e bordit, do të takohet me përfaqësuesit e Kryqit të Kuq dhe do të japë detaje të këtij plani në mbledhjen e ardhshme.

*Punë të tjera:*

- Sokoli dhe Ermiri duan të krijojnë një skuadër të re, atë të shahut. Ata plotësuan formatin e propozimit dhe bordi e aprovoi krijimin e skuadrës së re. Ata

---

<sup>14</sup> Me aktivitet jashtë qendrës nënkuptohen të gjitha aktivitetet që anëtarët e bordit organizojnë për fëmijë dhe të rinj që nuk marrin pjesë në aktivitetet që organizohen në qendër. Shumica e këtyre të rinjve nuk janë në shkollë ose janë banorë të dy fshatrave përreth që janë fare pranë me qytetin (si dy lagje të tij).

- NJË QENDËR RINORE E DREJTUAR NGA VETË TË RINJTË

duhet të mbajnë të informuar anëtarët e tjerë të bordit në lidhje me ecurinë e punës së kësaj skuadre të re. Plani i tyre final është të organizojnë një kampionat shahu brenda përfundimit të vitit shkollor.

- Ervisi të organizojë një aktivitet për mbledhje fondesh për disa familje të varfra. Bordi diskutoi mundësinë e një aktiviteti për mbledhje fondesh që mund të zgjaste gjatë gjithë vitit, por nuk u arrit të merrej asnjë vendim mbi kujt do t'i jepeshin këto para dhe për çfarë. Ata vendosën se një mënyrë e mirë organizimi për këtë qëllim do të ishte krijimi i një skuadre e cila do të drejtohet nga Ervisi. Ai do të plotësojë formatin e propozimit dhe do ta dorëzojë në mbledhjen e ardhshme.

*Vlerësimi i mbledhjes:*

- Anisa vë në dukje se mbledhjet po zgjasin 2.5 orë ndërkohë që duhet të jenë vetëm 2 orë. Ajo sugjeron se drejtuesi i mbledhjes duhet t'u tërheqë vëmendjen folësve që të mos zgjaten shumë dhe të mos dalin nga tema e diskutimit. Zv/presidenti tha se ajo kishte të drejtë dhe se herën tjetër do të përpiqeshin të ishin sa më koncizë.

Protokolli i mbledhjes u mbajt nga Alfredi, sekretari i bordit.

# Shtojca 2: - Shembuj të dobishëm për planifikimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e aktiviteteve

## Udhëzime për plotësimin e formatit për Planin e Aktivitetit

### Çfarë është formati i planit të aktivitetit?

- Është një format që të ndihmon të planifikosh hap pas hapi një aktivitet.

### Pse duhet ta plotësoj këtë format?

- Ai të ndihmon ta realizosh aktivitetin me sukses pasi e ke menduar mirë çdo hap për zbatimin e tij.
- Plotësimi i formatit është një nga kërkesat që duhet të plotësosh për të filluar një aktivitet, projekt apo klub të ri. (Nëse aktiviteti, klubi apo projekti yt është aprovuar, atëherë të duhet vetëm të marrësh aprovimin e bordit për aktivitetet e veçanta që ai mund të përmbajë).
- Ai të ndihmon edhe më pas, kur do të të duhet të përgatisësh raportin e aktivitetit të kryer.

### Kur duhet ta plotësoj formatin?

- Formatin plotësohet përpara se të nisësh ndonjë veprimtari.
- Nëse nevojitet aprovimi i bordit, formati duhet t'i prezantohet atij të paktën 2 javë përpara datës që ke përcaktuar si datënisje (pasi bordi mblidhet një herë në dy javë).

**Si ta plotësoj formatin?** Më poshtë japim shpjegime mbi si duhet të plotësohet secili prej seksioneve të formatit.

**Titulli i aktivitetit:** Ç'emër ka aktiviteti, klubi apo projekti? Përpiqu të gesh diçka që e bën tërheqës dhe përshkruet të klubit apo aktivitetit

**Çështjet apo Tema:** Cila është çështja, nevoja apo tema kryesore që do të trajtojë aktiviteti juaj?

**Lloji i aktivitetit:** Klube, Kurse, Aktivitete të ndryshme dhe Projekte

- **Klubi:** është një grup anëtarësh të qendrës rinore që kanë interes të përbashkët dhe që takohen rregullisht gjatë një periudhe të caktuar për të realizuar aktivitete të ndryshme. Klubi mund të jetë shumë joformal, me pjesëmarrës që marrin pjesë në aktivitete sipas interesit që kanë, por mund të jetë edhe i tillë që, për të qenë pjesëmarrës, duhet të marrësh pjesë

rregullisht në klub. Për shembull: një klub i Anglishtes është një klub joformal ku kushdo që flet anglisht mund të vijë e të marrë pjesë në takime për të diskutuar anglisht rreth një teme apo çështjeje, në një mjedis të qetë dhe argëtues.

- **Kurset:** organizohen rregullisht me pjesëmarrjen e të njëjtit grup të rinjsh apo fëmijësh gjatë një kohe të përcaktuar. Qëllimi i kursit është t'i pajisë të rinjtë me njohuri dhe aftësi të reja apo t'u japë informacion në lidhje me një temë të caktuar. Kurset apo mësimet kanë lidhje me njëri-tjetrin dhe për këtë arsye pjesëmarrësit duhet t'i ndjekin rregullisht. Për shembull: kurset e lidërsipit përfshijnë takime javore për një periudhë prej 3 muajsh.
- **Aktiviteti:** një aktivitet që përmban vetëm një ndodhi kërkon pak planifikim paraprak por, nëse aktiviteti është i shumëfishtë, atëherë nevojitet planifikim i detajuar. Aktivitetet mund të organizohen në qendrën rinore por edhe në komunitet. Këto mund të jenë për shembull: debate, trajnime sipas metodës të rinjtë-për-të rinjtë etj.
- **Projekti:** ky mund të jetë një ndodhi e organizuar vetëm një herë ose një shumicë komplekse aktivitete të organizuara më shumë se një herë, për shembull organizimi i pastrimit të 8 oborreve të shkollave të qytetit me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Shërbimit Vullnetar. Për këtë gjithashtu u përgatitën dhe printuan postera, u vizatuan logot dhe mesazhet si dhe u blenë bluzat për pjesëmarrësit, u organizuan disa aktivitete për mbledhjen e fondeve, u bënë disa takime me përfaqësues të pushtetit vendor dhe të drejtorive të shkollave etj.

**Drejtuesi:** cili është personi i ngarkuar për mbarëvajtjen e aktivitetit i cili mban përgjegjësi për organizimin dhe zbatimin e tij? Në përgjithësi, nuk nevojiten më shumë se një apo dy drejtues për aktivitetin.

**Vendi:** Në ç'vend do të bëhet aktiviteti? Përcaktoni vendin dhe kohën më të përshtatshme për pjesëmarrësit dhe të interesuarit për aktivitetin.

**Përshkrim i shkurtër:** Pse ky aktivitet? Pse është i nevojshëm apo prioritar organizimi i tij? Nga e dini se ky është një prioritet/nevojë? Si do ta trajtojë këtë nevojë ky aktivitet? Çfarë do të bëni dhe si do ta bëni?

**Datat/Kohëzgjatja:** Cilat janë datat dhe kohëzgjatja e aktiviteteve? Sa kohë nevojitet për përgatitjen, realizimin, reflektimin, festimet etj.?

**Qëllimi:** Cili është rezultati afatgjatë apo ndryshimi që doni të realizoni? Çfarë doni të realizoni? Kjo duhet shkruar qartë dhe duhet të jetë realiste e të japë edhe afatin kohor të nevojshëm.

**Objektivat:** Listoni 1 – 4 objektiva specifike, afatshkurtra, që do të kryeni për të realizuar qëllimin afatgjatë të aktivitetit. Këto duhet të jenë SMART: **S**pecifike, të **M**atshme, të **A**rritshme, **R**elevante (të përshtatshme) dhe me **K**ohë të përcaktuar.

- **Specifike:** Kush ose çfarë do të ndryshojë? Çfarë veprimtarish dhe ndryshimesh priten? Përfshini numra si për shembull sa njerëz do të marrin pjesë, me sa do të ndryshojë apo rritet diçka etj.
- **Të Matshme:** sigurohuni që të keni mjetet dhe burimet për të matur rezultatet.
- **Të Arritshme:** sigurohuni që rezultatet e dëshiruara të mos jenë aq të vështira për t'u realizuar saqë njerëzit të tremben dhe të heqin dorë J. Sigurohuni që, për të realizuar atë që dëshironi, t'i keni të gjitha burimet (kohën, paratë, njerëzit, materialet etj.). Mirë është që të përcaktoni rezultate që nuk janë të thjeshta për t'u realizuar, por as shumë të vështira, - pra diku në mes - në mënyrë që të jenë sfiduese dhe që t'u japin personave të përfshirë edhe mundësinë për t'u bërë krijues.
- **Relevante (të përshtatshme):** sigurohuni që çdo gjë të ketë lidhje me qëllimin dhe të jetë kuptimplotë.
- **Koha:** përcaktoni afate kohore për secilën veprimtari që duhet kryer (në ditën e caktuar, dy herë në muaj etj.)

Objektivat zakonisht radhiten pas një fjalie të tillë: Në fund të aktivitetit pjesëmarrësit do të jenë të aftë të:

**Rezultatet e pritshme:** Çfarë rezultatesh doni të arrini për secilin nga objektivat e përcaktuar? Cili është ndikimi që prisni? Çfarë reagimesh shpresoni të shkaktoni? Çfarë mendoni se do të ndodhë?

**Burimet apo mundësitë ekzistuese në komunitet:** Kush ose çfarë ekziston në komunitet që mund të përdoret prej jush? Si mund t'i përdorni burimet ekzistuese në mënyrë që të mos humbni kohë dhe para për t'i bërë vetë nga fillimi? Partneriteti me komunitetin jo vetëm që do të përmirësojë aktivitetin por edhe do të krijojë mundësi për vazhdimësi.

**Përfituesit/grupi i synuar:** Cilët janë përfituesit? Kujt do t'i shërbejë ky aktivitet? Kush do të përfitojë nga ky aktivitet? Ç'do të përfitojnë ata? (Përfitimet mund të përfshijnë aftësi të reja, ide, njohuri, përvojë, kontakte, qëndrime, sjellje etj.)

**Grupi i interesit:** Në grupin e interesit mund të jetë kushdo që ka aftësi ose interes për të kontribuar ose përfitur prej aktivitetit. Mendoni se kush do ta kryejë aktivitetin, kush do të përfitojë prej tij, kush do të përjetojë diçka pozitive për shkak të aktivitetit, kush është fuqplotë, kush ka autoritet apo vë në dispozicion burime në ndihmë të aktivitetit?

**Materialet/furnizimet:** Mendoni për gjithçka që ju nevojitet për të përgatitur, zbatuar dhe vlerësuar apo raportuar aktivitetin. Çfarë dispononi? Çfarë duhet të blini? Çfarë mund ta merrni borxh? Mendoni për gjithçka dhe kohë përpara. Nëse sendet që ju nevojiten nuk disponohen në qendrën rinore, atëherë plotësoni formatin e kërkesës për fonde.

**Plani për njoftimin dhe 'reklamën':** Cila është mënyra më efektive për të njoftuar grupin e synuar? Kur do të filloni të bëni njoftimet dhe reklamën për aktivitetin? A do të njoftoni median? Doni t'i bëni reklamë aktivitetit që më parë apo pasi ai të ndodhë? Si mund ta bëni atë interesant për ata që nuk dinë asgjë rreth tij?

**Reziqet e mundshme:** Çfarë mund të mos shkojë dhe aq mirë dhe çfarë mund të bëni ju që t'i shmangni vështirësitë apo pengesat (kohën e keqe, më shumë pjesëmarrës se parashikimi, shumë pak pjesëmarrës, njerëzit negativë ose përçarës, mospajtimin e të gjitha fondeve ose pajisjeve të nevojshme, një trajner që nuk njofton paraprakisht se nuk mund të vijë etj.)?

**Plani i monitorimit:** Çfarë do të bëni për të qenë të sigurt se aktiviteti ose projekti është duke ecur në rrugën e duhur dhe se po realizon siç duhet objektivat dhe qëllimin? Çfarë do të vëzhgoni dhe matni? Si, kur dhe sa shpesh do ta bëni këtë? Çfarë do të bëni nëse shihni se aktivitetet ose projekti nuk po ecin në rrugën e duhur?

**Plani i vlerësimit:** Si do ta kuptoni se aktiviteti juaj ishte i suksesshëm? Nga do ta merrni vesh se i realizuat objektivat dhe qëllimin? Çfarë duhet të vëzhgoni apo të matni për këtë qëllim? Si dhe kur do ta bëni një gjë të tillë?

**Plani i veprimt:** Cilat janë hapat specifike që do të ndërmerri për të kryer këtë aktivitet? Kush është përgjegjës për secilin hap? Cili është rezultati i pritshëm për secilin hap? Në ç'kohë fillon dhe mbaron?

## Një format i plotësuar (model) i Planit të Aktivitetit

**Titulli i Aktivitetit:** Kjo dorë nuk do të të lëndojë kurrë

**Tema:** Stop Dhunës Ndaj Grave

**Lloji i aktivitetit:** Klub i ri \_\_\_ Kurs i ri \_\_\_ Aktivitet  Projekt (që mund të përfshijë një shumicë aktivitetesh) \_\_\_

**Drejtues:** Anjeza dhe Era XYZ

**Vendi:** vende të ndryshme në qendër të Kuçovës

**Përshkrim i shkurtër:** (Cila është nevoja, me ç'mënyrë do të trajtohet, si dhe çfarë do të bëjmë) Në Shqipëri për dhunën ndaj grave flitet shumë pak. Kjo është diçka që duhet të ndryshojë në mënyrë që gratë dhe vajzat të fuqizohen për mbrojtjen e të drejtave të tyre. Shumë pak persona janë në dijeni të ditës ndërkombëtare për Eliminimin e Dhunës ndaj Grave – 25 Nëntorit. Për këtë, më 25 Nëntor, ne do të shkojmë kudo në qytet ku ka shumë burra dhe djem të shkollave të mesme, do t'u tregojmë atyre se është dita e eliminimit të Dhunës ndaj Grave dhe Vajzave dhe do t'u kërkojmë që ta mbështesin nismën tonë duke vizatuar konturin e dorës së tyre në fletën “Kjo dorë nuk do të të lëndojë kurrë”, pastaj ta firmosin atë dhe të shkruajnë ndonjë fjalë të këndshme apo vargje të ndonjë poeme për dashurinë e më pas t'ia japin gruas apo të dashurës së tyre.

**Data/Kohëzgjatja:** (përgatitja, ndodhia, reflektimi, përrurimi etj.)

Planifikimi: 24 Nëntor. Ndodhia: E Diel, 25 Nëntor, 1.5 orë. Përmbledhje në fund të aktivitetit. Raportimi të Shtunën më 1 Dhjetor.

**Qëllimi:** Rritja e ndërgjegjësimit për domosdoshmërinë e ndalimit të dhunës ndaj grave dhe vajzave në Kuçovë.

**Objektivat:** Më 25 Nëntor, brenda një kohe prej 1.5 ore:

- 1) Të informojmë të paktën 75 burra/djem për ditën ndërkombëtare për Eliminimin e Dhunës ndaj Grave dhe
- 2) Të përfshijmë 75 burra/djem në këtë nismë duke plotësuar fletët “Kjo dorë nuk do të të lëndojë kurrë”

**Rezultatet e pritshme:** Ne presim që prej anëtarëve të komunitetit të ketë reagime nga më të ndryshmet. Disa do të jenë entuziastë dhe disa të tjerë mund edhe të jenë negativë.

Në gjithashtu presim që vetëm ndonjë, në mos asnjë, të dijë diçka për ditën ndërkombëtare të Eliminimit të Dhunës ndaj Grave

**Burimet ekzistuese në komunitet** dhe si mendoni t'i përdorni ato. Përfaqësuese të shoqatës Gruaja në Zhvillim

**Përfituesit/grupi i synuar** dhe ç'përfitim do të kenë ata. Rritja e ndërgjegjësimit në lidhje me nevojën për të ndaluar çdo formë të dhunës ndaj grave dhe vajzave.

**Të tjerë grupe të interesit** dhe si do t'i përfshijmë ata: Gratë dhe vajzat do të përfitojnë duke u trajtuar me respekt si rezultat i rritjes së ndërgjegjësimit. Ne do t'i informojmë ato në lidhje me këtë aktivitet që do të zhvillojmë.

**Materiale/pajisje** që nevojiten dhe si do t'i sigurojmë (plotësoni formatin e kërkesës për fonde nëse është e nevojshme)

Shënues me ngjyra të ndryshme – nga Qendra Rinore. Drita do të printojë 75 kopje të fletës “Kjo dorë nuk do të të lëndojë kurrë”. Anjeza do t'i marrë kopjet nga Qendra Rinore.

**Plani i njoftimit:** Nuk nevojitet

**Rreziqe të mundshme** dhe plani për eliminimin apo zbutjen e tyre. Njerëzit mund të jenë të pasjellshëm apo të ashpër, të paimterësuar apo indiferentë, të zënë me punë apo edhe negativë – Për të parandaluar të tilla probleme, ne do të qarkullojmë të shoqëruar nga një i rritur dhe si fillim do t'i qasemi atyre që i njohim, që duken miqësorë, që nuk janë të zënë me punë etj. Nëse hasim në ndonjë problem, thjesht themi faleminderit dhe largohemi.

**Plani i Monitorimit:** (çfarë do të monitorohet, si dhe kur) Monitorimi do të bëhet nëpërmjet vëzhgimit të reagimit të njerëzve kur të jemi në rrugë dhe, nëse përjasja jonë është e pasaktë, atëherë do ta modifikojmë.

**Plani i vlerësimit:** (çfarë do të vlerësojmë, si dhe kur) Ne do të matim nëse do të mund të plotësojmë dot 75 fletët brenda 1,5 ore. Gjithashtu do të vëmë re dhe dokumentojmë reagimet e njerëzve ndaj çështjes në fjalë si dhe ndaj mënyrës se si është organizuar ky aktivitet.

## Format i Planit të Aktivitetit

**Titulli i aktivitetit:** \_\_\_\_\_

**Tema:** \_\_\_\_\_

**Lloji i aktivitetit:** Klub i ri\_\_\_\_ Kurs i ri\_\_\_\_ Aktivitet\_\_\_\_Projekt (që mund të përfshijë një shumicë aktivitetesh)\_\_\_\_

**Drejtues:** \_\_\_\_\_

**Vendi:** \_\_\_\_\_

**Përshkrim i shkurtër:** (Cila është nevoja, me ç'mënyrë do të trajtohet, si dhe çfarë do të bëjmë)

\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

**Data/Kohëzgjatja:** (përgatitja, zbatimi, reflektimi, përfundimi etj.) \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

**Qëllimi:** (ndryshimi afatgjatë që doni të realizoni): \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

**Objektivat:** (listoni 1 – 4 objektiva afatshkurtër që do të ndihmojnë në realizimin e qëllimit)

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

**Rezultatet e pritshme:** \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

- NJË QENDËR RINORE E DREJTUAR NGA VETË TË RINJTË

**Burimet ekzistuese në komunitet** (dhe si keni menduar t'i përdorni ato). \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

**Përfituesit/grupi i synuar** dhe ç'përfitim do të kenë ata. \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

**Materiale/pajisje** që nevojiten dhe si do t'i sigurojmë (plotësoni formatin e kërkesës për fonde nëse është e nevojshme)

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

**Plani i njoftimit:** \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

**Rreziqe të mundshme** dhe plani për eliminimin apo zbutjen e tyre. \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

**Plani i Monitorimit:** (çfarë do të monitorohet, si dhe kur) \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

**Plani i vlerësimit:** (çfarë do të vlerësojmë, si dhe kur) \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

Përgatitur nga: \_\_\_\_\_ Data e dorëzimit \_\_\_\_\_

**Aprovuar nga:**

Bordi Rinor i Qendrës Rinore: \_\_\_\_\_ Data: \_\_\_\_\_

Kordinatori i Qendrës Rinore \_\_\_\_\_ Data: \_\_\_\_\_

## Plani i Veprimit - Shembull

### Titulli i Aktivitetit: Kjo dorë nuk do të të lëdojë kurrë

	Çështjet	Drejtues	Rezultate të dëshiruara	Data e fillimit	Data e mbarimit	Shënime
1	Përgatitja e fletëve	Anjeza	Një fletë, tërheqëse në pamje dhe interesante në përmbajtje	20-Nëntor	20-Nëntor	Do të hartojmë të paktën dy modele
2	Printimi i fletëve	Juli	-	20-Nëntor	23-Nëntor	
3	Shumëfishimi i fletëve	Anjeza	Në 75 kopje	24-Nëntor	24-Nëntor	
4	Sigurimi i shënuesve dhe ngjyrave	Juli	Të sigurojmë lapsa shumëngjyrësh për të plotësuar shijet e secilit	24-Nëntor	24-Nëntor	
5	Përcaktimi i ditës dhe orës së fillimit/mbarimit	Anjeza	Të zgjedhim një kohë të përshtatshme në të cilën njerëzit dalin për shëtitje dhe janë më pak të preokupuar	24-Nëntor	24-Nëntor	Këtë do ta vendosim si grup
6	Përcaktimi i vendeve që do të frekuentohen	Anjeza	Hartëzimi i vendeve që mendojmë se do të kenë më shumë sukses	24-Nëntor	25-Nëntor	Këtë do ta vendosim si grup
7	Përcaktimi i personave që do të marrin pjesë dhe i vendit se ku do të shkojë secili	Anjeza	Të krijojmë grupe personash që njihen dhe ndihen rehat me njëri-tjetrin	24- Nëntor	25-Nëntor	Këtë do ta vendosim si grup
8	Përcaktimi i asaj që do të thotë secili (prezantimi)	Anjeza	Të jemi të sjellshëm, të shprehemi qartë dhe shkurtimisht	24- Nëntor	24- Nëntor	Këtë do ta vendosim si grup
9	Etj.					
10						

- NJË QENDËR RINORE E DREJTUAR NGA VETË TË RINJTË

11						
12						
13						
14						

Shënime: \_\_\_\_\_

## Fleta e Planit të Veprimit

**Titulli i Aktivitetit:** \_\_\_\_\_

	Çështjet	Drejtues	Rezultate të dëshiruara	Data e fillimit	Data e mbarimit	Shënime
1						
2						
3						
4						
5						
6						
7						
8						
9						
10						

Shënime: \_\_\_\_\_

## Udhëzime për Monitorimin dhe Vlerësimin e Aktiviteteve

### Ç'është "Monitorimi dhe Vlerësimi"?

- Monitorimi është një nga mjetet e menaxhimit që na ndihmon të matim progresin e bërë përkundëjt realizimit të qëllimit dhe objektivave të përcaktuar. Ai përqendrohet tek realizimi i hapave afatshkurtër, në krahasim me planin fillestar. Monitorimi na tregon nëse jemi apo jo duke ecur në rrugën e duhur.
- Vlerësimi është mjeti nëpërmjet të cilit maten rezultatet dhe ndikimi i projektit në tërësi dhe siguron të dhëna për projekte të ngjashme për të ardhmen. Vlerësimi zakonisht ndërmerret në fund të projektit.

### Pse nevojiten monitorimi dhe vlerësimi?

- Plani i monitorimit dhe vlerësimit nxit të menduarit dhe ndihmon në hartimin qartë të qëllimit dhe objektivave. Si rezultat, projekti në tërësi hartohet më saktë.
- Ai ndihmon të kuptojmë nëse aktivitetet ishin apo jo të suksesshme dhe nëse patën ndikimin e parashikuar apo jo.

### Kur duhet hartuar plani i monitorimit dhe vlerësimit?

- Plani i monitorimit dhe vlerësimit duhet hartuar gjatë procesit të planifikimit të projektit. Kjo ndihmon për të planifikuar hapat shtesë që nevojiten për të pasur informacionin e duhur dhe të nevojshëm për të matur suksesin e aktivitetit/teve.

Çfarë të monitorosh	Si të monitorosh
Interesin dhe motivimin	Praninë, pjesëmarrjen, pjesëmarrësit e rinj, punën në skuadër, punët e kryera, realizimin e detyrës etj.
Trajnimet dhe shkollimin	Praninë, materialet e përvetësuara, zhvillimin e aftësive të reja, cilësinë e punës së kryer etj.
Detyrat specifike të kryera	Numri i artikujve të dhënë/marrë, % e detyrave të kryera në kohë etj.
Buxhetin	Krahasimi i shpenzimeve aktuale me shpenzimet e propozuara në plan etj.

- NJË QENDËR RINORE E DREJTUAR NGA VETË TË RINJTË

<b>Çfarë të vlerësosh</b>	<b>Si të vlerësosh</b>
A janë realizuar qëllimi dhe objektivat?	Teste para dhe pas aktivitetit, vëzhgime, matje, llogaritje, diskutime në grup, intervista etj.
A kishte projekti efekt pozitiv ndaj pjesëmarrësve dhe komunitetit?	Formate vlerësimi, mbledhje, intervista, vëzhgime nëpërmjet një liste-kontrolli etj.
A përfituan pjesëmarrësit aftësi të reja, njohuri apo përvojë? (Kush? Çfarë % suksesi dhe çfarë aftësish/njohurish shfaqin ata?)	Përpara: vëzhgoni aftësinë e tyre për të kuptuar/kryer detyra, pyesni nëse ata kanë marrë pjesë më parë në një aktivitet të tillë ose kërkoni që të plotësojnë një fletë me të dhëna për aftësitë/njohuritë apo përvojën e deritanishme. Llogarisni përgjigjet. Pas: Llogarisni se sa prej tyre tregojnë përmirësim.
A përftuan pjesëmarrësit role dhe funksione të reja? (Kush dhe çfarë rolesh do të kryejnë ata?)	Përpara: vëzhgoni ose pyetini ata për funksionet dhe rolet e deritanishme. Llogarisni përgjigjet. Gjatë/Pas: vëzhgoni ndryshimin.
A perceptojnë pjesëmarrësit ndonjë ndryshim në cilësinë e jetës së tyre? (Kush? Në çfarë përqindjeje është ndryshuar, çfarë do të ndryshojë, si e dini ju këtë?)	Përpara: vëzhgoni ose pyetini ata në lidhje me jetën apo cilësinë e jetës së tyre. Llogarisni përgjigjet. Gjatë/Pas: vëzhgoni ose pyetini për ndryshimin.
A e ndryshuan pjesëmarrësit qëndrimin e tyre apo perceptimin ndaj vetes, të tjerëve apo një çështjeje të caktuar? (Kush, në çfarë % ka ndryshuar, çfarë ka ndryshuar, si e dini ju këtë?)	Përpara aktivitetit, vëzhgoni ose pyetini në lidhje me perceptimin ndaj vetes dhe të tjerëve. Kërkoni prej tyre të ngrenë dorën nëse janë dakord me deklaratimet e bëra. Llogarisni përgjigjet. Gjatë/Pas: vëzhgoni ose drejtoni sërish të njëjtën pyetje.
A ndërmarrin pjesëmarrësit ndonjë veprim? (Kush, në çfarë % ka ndryshuar, çfarë ka ndryshuar, si e dini ju këtë?)	Përpara: kërkoni prej tyre të shkruajnë nëse ose sa shpesh ata bëjnë një veprimtari të caktuar. Pas: Bëni të njëjtën pyetje për të parë nëse sjellja e tyre ka ndryshuar apo jo ose thjesht vëzhgoni sjelljen e tyre.



**QENDRA RINORE  
KUÇOVË**

## Pyetësor para trajnimit - shembull

### Trajnim për drejtuesit e Bordit Rinor 2 – 4 Dhjetor 2007

- 1** Ky është viti im i parë si anëtar i Bordit Rinor të Qendrës rinore Kuçovë. Po\_\_\_\_ Jo\_\_\_\_  
Nëse jo, shëno kohën kur je bërë anëtar i bordit: \_\_\_\_\_
- 2** Unë kam qenë anëtar i Bordit Rinor të Qendrës Rinore (President, Sekretar, Financier etj.). Po\_\_\_\_ Jo\_\_\_\_  
Nëse po, shëno rolin që ke pasur dhe afatet kohore për secilin: \_\_\_\_\_
- 3** Unë kam ndihmuar në organizimin apo drejtimin e një aktiviteti ose projekti të Qendrës Rinore Kuçovë: Po\_\_\_\_ Jo\_\_\_\_  
Nëse po, shëno aktivitetin dhe datën. \_\_\_\_\_

Nga 1 – 5, sa të sigurt jeni lidhur me aftësinë për të realizuar me sukses veprimtaritë e mëposhtme?

Veprimtaria	1 Aspak i/e sigurt	2	3	4	5 Shumë i/e sigurt
4. Shpjegimi i qëllimit të bordit					
5. Shpjegimi i rolit dhe përgjegjësive të anëtarëve të bordit si dhe të grupit drejtues brenda bordit					
6. Marrja e vendimeve të duhura si anëtar i bordit					
7. Shkrimi i qëllimit dhe objektivave të një aktiviteti					
8. Shkrimi i propozimeve për aktivitete në Qendrën Rinore					
9. Planifikimi dhe zbatimi me sukses i aktiviteteve në Qendrën Rinore					
10. Vlerësimi i aktivitetit, nëse ishte i suksesshëm apo jo					
11. Shkrimi i raporteve të sakta për një aktivitet në Qendrën Rinore					

- NJË QENDËR RINORE E DREJTUAR NGA VETË TË RINJTË

Veprimtaria	1 Aspak i/e sigurt	2	3	4	5 Shumë i/e sigurt
12. Puna në skuadër me anëtarë të tjerë të bordit					
13. Krijimi i një plani aktiviteteesh për Qendrën Rinore i cili bazohet tek nevojat dhe interesat dhe përfshin kohën dhe objektivat më kryesore					

**14** Shkruani diçka që shpresoni të mësoni nga ky trajnim? \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

**15** Çfarë doni të realizoni gjatë kohës që jeni i zgjedhur si anëtar i bordit?

- Një aftësi që doni të përftoni: \_\_\_\_\_

- Një aktivitet që doni të organizoni: \_\_\_\_\_

- Tjetër: \_\_\_\_\_

**16** Çfarë ju shtyn të bëheni anëtar i bordit? \_\_\_\_\_



**QENDRA RINORE  
KUÇOVË**

## Shembull - Formati i Vlerësimit

**Trajnimi i Bordit Rinor Drejtues  
2 – 4 Dhjetor 2007**

**Ju lutemi shprehni komentet tuaja në lidhje me cilësinë e trajnimit me qëllim që trajnimet e ardhshme të jenë më të mira.**

	<b>Plotësisht Dakord</b>	<b>Dakord</b>	<b>Neutral</b>	<b>Nuk jam Dakord</b>	<b>Aspak Dakord</b>
1. Trajnimi më pëlqeu					
2. Në këtë trajnim përfitova aftësi të vlefshme					
3. Si rezultat i këtij trajnimi, ndihem më i sigurt për aftësinë time për të qenë anëtar efektiv i Bordit Rinor të Qendrës					
4. Si rezultat i këtij trajnimi ndihem më i lidhur me anëtarët e tjerë të bordit					
5. Jam i kënaqur me cilësinë e materialeve të trajnimit					
6. Jam i kënaqur me metodën e trajnimit					

**Nga 1 – 5, sa i/e sigurt je në aftësinë për:**

<b>Veprimtaria</b>	<b>1 Aspak i/e sigurt</b>	<b>2</b>	<b>3</b>	<b>4</b>	<b>5 Shumë i/e sigurt</b>
7. Të shpjeguar qëllimin e bordit					
8. Të shpjeguar rolin dhe përgjegjësitë e anëtarëve të bordit si dhe të grupit drejtues brenda bordit					
9. Të marrë vendimet e duhura si anëtar i bordit					
10. Të shkruar qëllimin dhe objektivat e një aktiviteti					
11. Të shkruar propozime për aktivitete në Qendrën Rinore					

- NJË QENDËR RINORE E DREJTUAR NGA VETË TË RINJTË

<b>Veprimtaria</b>	<b>1</b> Aspak i/e sigurt	<b>2</b>	<b>3</b>	<b>4</b>	<b>5</b> Shumë i/e sigurt
12. Të planifikuar dhe zbatuar me sukses aktivitete në Qendrën Rinore					
13. Të vlerësuar nëse aktiviteti ishte apo jo i suksesshëm					
14. Të shkruar raporte të sakta për një aktivitet në Qendrën Rinore					
15. Të punuar në skuadër me të tjerë anëtarë të bordit					
16. Të krijuar një plan aktivitete për Qendrën Rinore i cili bazohet në nevojat dhe interesat dhe përfshin kohën dhe objektivat më kryesore					

**17** Aspekti më interesant i trajnimit ishte...

---

**18** Aspekti më pa interes i trajnimit ishte ...

---

**19** Trajnimi mund të përmirësohet duke ...

---

**20** Diçka që duhet ta kishim diskutuar por nuk e bëmë:

---

**Faleminderit shumë!**

## Udhëzime për Raportimin e Aktivitetit

### Çfarë është një raport aktiviteti?

- Raporti është një mjet që ndihmon në dokumentimin e hapave të ndryshëm të një aktiviteti, por edhe të rezultateve të tij. Për këtë mund të përdoret një format i caktuar, formati i raportit.

### Pse duhet plotësuar ky format?

- I jep besueshmëri një pune të kryer më së miri.
- Siguron përmirësimin e aktiviteteve të ardhshme, pasi ju dhe të tjerët mund të mësoni nga puna e kryer.
- Ju shërben si shpërblim apo si “faleminderit” për aktivitetin që keni kryer.
- Shërben si dokumentacion për aktivitetet e kryera në qendrën rinore.

### Kur duhet plotësuar ky format?

- Formatu duhet plotësuar (në varësi të specifikës së aktivitetit/projektit) brenda një jave pas mbarimit të aktivitetit dhe duhet t'i dorëzohet bordit rinor.

### Si duhet plotësuar ky format?

- Më poshtë shpjegojmë detaje për mënyrën e plotësimit të secilit seksion të formatit të raportimit.

---

<b>Titulli i aktivitetit:</b>	Si është quajtur Klubi, Kursi, Aktiviteti apo Projekti?
<b>Tema:</b>	Cila është tema, nevoja ose çështja të cilën do të trajtojë aktiviteti juaj?
<b>Drejtuesi:</b>	Kush është personi përgjegjës për aktivitetin?
<b>Vendi:</b>	Ku u krye/ndodhi aktiviteti?
<b>Datat/kohëzgjatja:</b>	Në ç'data dhe sa zgjati aktiviteti? Këtu përfshihet edhe koha për përgatitje, reflektim, përfundim etj.
<b>Përmbledhje:</b>	Çfarë ndodhi? Çfarë kryet, kush dhe si e kryet?
<b>Qëllimi:</b>	Rishkruani qëllimin e aktivitetit sikurse është në Formatin e Planit të Aktivitetit.
<b>Objektivat:</b>	Rishkruani objektivat që keni përmendur në Formatin e Planit të Aktivitetit.
<b>Rezultatet:</b>	Shkruani nëse i keni realizuar plotësisht, pjesërisht apo aspak objektivat e aktivitetit. Listoni me detaje çfarë keni realizuar dhe çfarë jo.

- NJË QENDËR RINORE E DREJTUAR NGA VETË TË RINJTË

<b>Pjesëmarrësit:</b>	Listoni sa djem/vajza morën pjesë. Listoni emrat dhe, nëse është e mundur, i bashkëngjisni këtij dokumenti edhe një listë-prezencë që tregon pjesëmarrjen. Në listë duhet të mbani shënim edhe pjesëmarrësit e rritur dhe rolet e tyre në këtë aktivitet.
<b>Pjesëmarrja e të rinjve:</b>	Shpjegoni rolin dhe përgjegjësinë e të rinjve që morën pjesë në aktivitet. A ishin ata thjesht pjesëmarrës apo ishin përgjegjës për organizimin dhe zbatimin e aktivitetit?
<b>Të rëndësishme:</b>	Listoni çdo gjë që sipas jush ishte shumë interesante, pozitive dhe e rëndësishme për t'u përmendur.
<b>Sfidat:</b>	Listoni vështirësitë/sfidat e ndeshura, si ia dolët mbanë dhe çfarë ndikimi sollën?
<b>Mësime/Sugjerime për herë të tjera:</b>	Listoni çfarë mësuat nga ky aktivitet. Listoni rekomandimet tuaja për këdo që do të dëshironte të bënte të njëjtin aktivitet në të ardhmen.

---

## Raporti i Aktivitetit - Shembull

- Titulli i Aktivitetit:** Kjo dorë nuk do të të lëndojë kurrë
- Tema/çështja:** Të ndalojmë dhunën ndaj grave dhe vajzave
- Drejtues:** Anjeza ..... dhe Era.....
- Vendi:** Vende të ndryshme në qendër të Kuçovës
- Datat/Kohëzgjatja:** (përgatitja, zbatimi, reflektimi, përfundimi, raportimi etj). Planifikimi: 24 Nëntor, 2007. Zbatimi: E Die, 25 Nëntor, 2007, I. 5 orë. Takim i shkurtër pas aktivitetit. Shkrimi i raportit të Shtunën I Dhjetor, 2007
- Përmbledhje:** 5 të rinj nga Qendra Rinore dhe 2 vullnetarë të Korpusit të Paqes shkuan në vende të ndryshme në qendër të qytetit (restorante, kafene, qoshe rrugësh, dyqane), iu qasën burrave dhe djemve të rinj nga shkolla e mesme dhe i informuan mbi Ditën Ndërkombëtare për Eliminimin e Dhunës ndaj Grave dhe Vajzave. Gjithashtu i pyetën nëse donin të tregonin angazhimin dhe mbështetjen lidhur me këtë çështje duke vizatuar konturin e dorës së tyre në një fletë të quajtur "Kjo dorë nuk do të të lëndojë kurrë", duke e firmosur atë dhe duke shkruar ndonjë fjalë të dashur apo ndonjë varg dashurie (nëse dinin) për gruan apo të dashurën e tyre. Shumica e personave të cilëve të rinjtë iu qasën morën pjesë me kënaqësi; disa ishin shumë entuziastë dhe e vlerësuan shumë këtë nismë. Disa të tjerë nuk ishin të interesuar dhe bënë shaka. Në përgjithësi ishte përvojë pozitive. Ne mund të kishim plotësuar edhe më shumë se 75 copë pa problem.
- Qëllimi:** Rritja e ndërgjegjësimit për domosdoshmërinë e ndalimit të dhunës ndaj grave dhe vajzave në Kuçovë.

### Rezultatet

Objektivat	Arritjet
1. Të informojmë të paktën 75 burra/djem mbi ditën ndërkombëtare për Eliminimin e Dhunës ndaj Grave	1. 100 burra/djem nga Kuçova u informuan për Ditën Ndërkombëtare për Eliminimin e Dhunës ndaj Grave
2. Të përfshijmë 75 burra/djem në këtë nismë duke plotësuar fletët "Kjo dorë nuk do të të lëndojë kurrë"	2. 75 burra/djem nga Kuçova morën pjesë në aktivitetin "Kjo dorë nuk do të të lëndojë kurrë". Aktiviteti u realizua sipas kohës së parashikuar, 1.5 orë
3.	3. 5 vajza të reja fituan besimin dhe përvojën e duhur për organizimin dhe zbatimin e aktiviteteve ndërgjegjësuese për komunitetin.

- Pjesëmarrësit:** 5 vajza: Anjeza ..., Erjola ....., Dreida ....., Anisa ....., Florida ..... 2 vullnetarë të Korpusit të Paqes: Xhulieta dhe Ryan.
- Pjesëmarrja e të rinjve:** Të rinjtë mësuan rreth fenomenit të dhunës në familje nëpërmjet diskutimit me vullnetarët. Ideja për organizimin e aktivitetit ishte e vullnetarëve, por të rinjtë u përfshinë në zbatimin e aktivitetit, hartuan fletët, i shumëfishuan ato, hartuan planin se ku do të shkonin dhe se çfarë do të thoshin si dhe e zbatuan atë.
- Të rëndësishme:** Një tjetër gjë e rëndësishme në këtë aktivitet ishte vlerësimi që morëm nga burrat/djemetë të cilët e quajtën këtë aktivitet si një ide të mirë. Ne nuk ishim të sigurt se ç'reakim do të shkaktonte ky aktivitet dhe në fakt ishim disi të nervozuar. Për këtë arsye, pjesëmarrja e aq shumë njerëzve ishte vërtet motivuese.
- Sfidat:** Disa nga pjesëmarrësit e skuadrës ishin të shqetësuar për reagimin e pritur dhe të frikësuar se mos ngjanin qesharakë. Ne vendosëm që në aktivitet të merrnin pjesë vetëm ata që ndiheshin të sigurt. Kur dikush ishte negativ, ne thjesht e falënderonim dhe largoheshim.
- Mësime/Sugjerime për herë të tjera:** Restorantet dhe kafenetë ishin vendet më të përshtatshme në këtë rast. Kjo për arsye se njerëzit na shikonin dhe bëheshin kureshtarë. Kur dikush shikonte të tjerët të merrnin pjesë, përfshihej edhe vetë. Gjithashtu ishte e rëndësishme që, para se t'i afroheshim klientëve, t'i merrnim leje pronarit të lokalit. Grupet e djemve adoleshentë tentonin të talleshin me idenë tonë, ndërsa qasja e burrave që ishin të shoqëruar nga gratë e tyre funksiononte fare mirë.

## Raporti i Aktivitetit

**Titulli:** \_\_\_\_\_

**Tema/çështja:** \_\_\_\_\_

**Drejtuesi:** \_\_\_\_\_ **Vendi:** \_\_\_\_\_

**Datat/kohëzgjatja:** (përgatitja, zbatimi, reflektimi, përfundimi etj.): \_\_\_\_\_

**Përmbledhje:** \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

**Qëllimi:** \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

### Rezultatet

Objektivat	Arritjet
1.	1.
2.	2.
3.	3.
4.	4.

**Pjesëmarrësit:** \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

**Pjesëmarrja e të rinjve:** \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

**Të rëndësishme:** \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

- NJË QENDËR RINORE E DREJTUAR NGA VETË TË RINJTË

**Sfidat:**

---



---

**Mësimet / Sugjerimet**

**për herë të tjera:**

---



---



---

## Kërkesa për fonde

Data e kërkesës: \_\_\_\_\_

Emri i Drejtuesit të Aktivitetit: \_\_\_\_\_

Titulli i Aktivitetit: \_\_\_\_\_

Data e Aktivitetit: \_\_\_\_\_ vendi : \_\_\_\_\_

	Përshkrimi	Njësi	Kosto/ Njësi	Lloji i njësisë	Shuma
1					
2					
3					
4					
5					
6					
7					
8					

Aprovuar nga:

	Financier i Bordit	Punonjësi i Qendrës Rinore
Data e paraqitjes:		
Rishikuar nga:		
Vendimi për aprovim:	Po:                      Jo:	Po:                      Jo:
Data e vendimit:		
Komente:		

# Shtojca 3 – Trajnimi i të rinjve 'Të rinjtë për të rinjtë'

## MODULET E TRAJNIMIT

### Hyrje

#### Të dashur të rinj trajnerë!

Mbështetur në eksperiencën e punës disa-vjeçare me një grup të rinjsh, vendosëm të zhvillojmë disa module trajnimi për t'ju ndihmuar në punën tuaj si trajnerë, lehtësues apo këshillues për të rinjtë në nevojë;

Të bëhesh një trajner apo lehtësues i mirë është një proces i gjatë dhe i vështirë që kërkon shumë përkushtim e punë për të mësuar dhe për t'u përmirësuar në vazhdimësi;

Ky proces fokusohet në përmirësimin e tre elementeve kryesorë si më poshtë:

- Njohuritë (K-knowledge)
- Aftësitë (S-skills)
- Qëndrimet (A-attitude)

Zhvillimi dhe thellimi i **njohurive** në temat që do të trajtoni apo lehtësoni, është një proces i rëndësishëm dhe i pandërprerë; të rinjtë bashkëmoshatarë duhet të shohin tek ju ekspertin që e njeh mirë teorikisht temën që po zhvillohet;

Zhvillimi dhe praktikimi i **aftësive trajnuese** dhe **lehtësuese** është po ashtu një element i domosdoshëm për t'u bërë trajner efektiv; këto aftësi zhvillohen duke i praktikuar shpesh dhe duke njohur cilësitë dhe rolet që një trajner / lehtësues i mirë duhet të ketë. Disa nga aftësitë që duhet të zhvillohen janë: aftësitë komunikuese, organizuese, adoptuese, vendimmarrëse etj.

**Qëndrimet** kanë të bëjnë me demonstrimin e dëshirës, përkushtimit, motivimit, respektit për të punuar me të rinjtë në nevojë.

**Cilat janë disa cilësi që duhet të ketë një trajner/lehtësues efektiv?**

#### Të jetë:

- Bashkëpunues
- Adoptues
- I organizuar mirë
- Me nivel të lartë njohurish
- I ndjeshëm
- I vëmendshëm
- Krijues

**Cilat janë rolet kryesore që një trajner/ lehtësues efektiv luan?**

- E përshtat programin sipas rrethanave
- Iu reziston individëve të vështirë
- Krijon dhe mban një ton respektues
- Përdor shumë materiale apeluese vizuale
- I dëgjon pjesëmarrësit me vëmendje
- E njeh mirë teorikisht materialin që prezanton
- E rregullon ambientin ku zhvillohet trajnimi në mënyrë të përshtatshme si dhe sigurohet se ka të gjitha mjetet mbështetëse

**Si përdoret manuali?**

Jemi munduar të japim mënyra të ndryshme se si organizohet dhe zhvillohet një program trajnimi; ju mund t'i përdorni këto module si shembull kur do të trajtoni të rinjtë bashkëmoshatarë në tema të ndryshme dhe t'i adaptoni ato sipas stilit tuaj, grupmohës dhe preferencave të pjesëmarrësve si dhe qëllimeve dhe objektivave të trajnimit.

## “Të Rinjtë për të Rinjtë” Prezantim i Metodës “Të rinjtë për të rinjtë”

**Mosha:** 14-18 vjeç

**Qëllimi:** Ndërtimi i aftësive të një grupi të rinjsh adoleshentë për të ndihmuar bashkëmoshatarët e tyre të përballen efektivisht me problemet që has kjo grupmoshë

**Objektivat:** **Në fund të programit pjesëmarrësit do të:**

- Demonstronjë se e kuptojnë rëndësinë dhe procesin e metodës “Të Rinjtë për të Rinjtë”
- Demonstronjë se kuptojnë cilësitë dhe aftësitë që duhet të ketë një trajner/këshillues/ndihmës të rinjsh
- Demonstronjë dëshirë dhe entuziazëm për t’u përfshirë në program

**Kohëzgjatja:** 2 ditë

**Nr. i pjesëmarrësve:** 20-25 të rinj

### Rendi i ditës

AKTIVITETI	KOHA	METODA	MJETE
Prezantimi i pjesëmarrësve Prezantimi i Programit Pritshmëria për Programin Rregullat e Punës	45 min.	Vizatime dhe punë në grupe dyshe Prezantim nga lehtësuesi <i>Brainstorming</i>	
Çfarë është metoda “Të Rinjtë për të Rinjtë”? Avantazhet / Sfidat	30 minuta	<i>Brainstorming</i> Prezantim nga lehtësuesi	
Ushtrim për Nxemje	30 min	Forcimi i besimit tek njëri-tjetri	
Cilat janë disa cilësi të vlefshme për të këshilluar bashkëmoshatarët?	30 minuta	Prezantim nga lehtësuesi. <i>Brainstorming</i> Punë individuale dhe ndarje në grupe pune Reflektim	

- NJË QENDËR RINORE E DREJTUAR NGA VETË TË RINJTË

<b>AKTIVITETI</b>	<b>KOHA</b>	<b>METODA</b>	<b>MJETE</b>
Ushtrim për Nxemje	30 minuta		
Si mësojnë të rriturit? Cikli i të mësuarit eksperimental Pedagogji / andragogji (të përbashkëtat / të veçantat)	15 minuta	Prezantim nga trajneri/ bashkëbisedim	Cikli i të mësuarit për të rriturit
Ushtrim për Nxemje	15 minuta		
Cilat janë problemet që hasin sot të rinjtë Cikli i problemeve “MOOR”	45minuta	Diskutim në grup/ debat	Cikli MOOR i Problemeve
Cili është stili juaj në përballjen me konfliktin? Çfarë mësuar nga ky ushtrim? Mësuar ndonjë gjë për veten tuaj?	45 minuta	Inventar	Inventari
Cilat janë aftësitë tuaja për të bashkëpunuar? Dilema e të burgosurit Fitoni sa më shumë...	45 minuta	Lojë	Fleta e punës
Çfarë mësuar nga loja? Çfarë tregon qëndrimi “X” dhe çfarë mesazhi jep qëndrimi “Y”	15 minuta		
Diskutim për Kësulëkuqen dhe Ujkun e Keq Çfarë mësuar nga kjo histori? Cila është lidhja e historisë me rolin tuaj si ndihmës i bashkëmoshatarëve?	20 minuta	Diskutim	Ushtrimi

AKTIVITETI	KOHA	METODA	MJETE
Aftësitë për të komunikuar			
Tregoni se çfarë dëgjuat?	30 minuta	Lojë për të parë aftësitë për të dëgjuar dhe për të mbajtur mend	
Vendimmarrja në grup	45 minuta		Fleta e ushtrimit
Përmbledhja e sesionit/ vlerësimi i programit	15 minuta		

- Temat e trajtuara**
- Çfarë është metoda “Të Rinjtë për të Rinjtë”? Avantazhet / Sfidat
  - Cilat janë disa cilësi të vlefshme për të këshilluar bashkëmoshatarët?
  - Cikli i të mësuarit eksperimental/ Si mësojnë të rriturit?
  - Pedagogji / andragogji (të përbashkëtat / të veçantat)
  - Cilat janë problemet që hasin sot të rinjtë
  - Cikli i problemeve “MOOR”
  - Cili është stili juaj në përballjen me konfliktin?
  - Dilema e të burgosurit
  - Diskutim për Kësulëkuqen dhe Ujkun e Keq
  - Aftësitë për të komunikuar
  - Vendimmarrja në grup

### Metodologjia

Metodat kryesore të përdorura gjatë trajnimit:

- *Brainstorming*
- Punë dhe diskutime në grup të madh dhe të vogël
- Simulim
- Inskenime
- Ushtrime për nxemje
- Leksione të shkurtra
- Reflektim
- Diskutim i strukturuar

### Rekomandim se si mund të zhvillohet ky sesion:

Trajnimi mund të fillojë me një *brainstorming* se çfarë është metoda “Të rinjtë për të rinjtë” si dhe cilat janë përfitimet e përdorimit të kësaj metode.

Tema për diskutim dhe debat “Cilat janë disa cilësi dhe aftësi të nevojshme për të këshilluar/ ndihmuar të rinjtë” mund të ngjallë shumë interes dhe të rinjtë do të japin kontributin e tyre duke përmendur cilësitë kryesore siç janë:

- aftësia për të vendosur raporte besimi;
- aftësia për të dëgjuar dhe kuptuar;
- aftësia për të shfaqur empati;
- mbajtja e fshehtësisë; etj

Cikli i të mësuarit për të rriturit po ashtu ngjall shumë interesim tek të rinjtë, të cilët kuptojnë që stili përfshirës është më efektiv për të mësuar dhe praktikuar njohuritë e marra.

Stilet e pjesëmarrësve për t’u përballur me konfliktin këshillohet të identifikohen nëpërmjet sondazhit të Thomas Kilman për “Stilet e konfliktit”. Pasi të jenë identifikuar stilet, trajneri duhet të përmendë anët pozitive dhe pikat e dobëta të secilit stil, duke i influencuar të rinjtë që ata të mund ta shohin ndryshueshmërinë e stileve të tyre të menaxhimit të konflikteve si një forcë pozitive në punën e tyre së bashku si dhe në menaxhimin me sukses të konflikteve;

Trajneri mund të komentojë që dominimi i stilit konkurrues në menaxhimin e mosmarrëveshjeve është i pranueshëm në situata të caktuara por në rolin e trajnerit/ ndihmësit të të rinjve mund të ulë efektivitetin. Trajneri duhet të punojë me këta të rinj për t’i ndihmuar ata të zhvillojnë stilin akomodues dhe konsensual në zgjidhjen e problemeve dhe menaxhimin e konflikteve.

Dëgjimi i të gjitha palëve të përfshira në konflikt si dhe të menduarit jashtë kornizës mund të zhvillohen duke bërë ushtrime të ndryshme si dhe duke inskenuar role të ndryshme.

Zhvillimi i të dëgjuarit aktiv nëpërmjet drejtimit të pyetjeve të hapura si dhe perifraximi dhe përmbledhja mund të zhvillohen nëpërmjet ushtrimeve të ndryshme dhe mund ta shndërrojnë ambientin e trajnimit në një vend të gëzueshëm për të rinjtë pjesëmarrës.

Aftësitë për të punuar në grup si dhe aftësitë ndërvepruese mund të zhvillohen nëpërmjet një ushtrimi simulues.

## “Të Rinjtë për të Rinjtë”

### Të formojmë aftësitë për të këshilluar të rinjtë

#### Objektivat:

#### Në fund të programit pjesëmarrësit do të:

- njohin metodën e Analizës Vlerësuese
- inkurajohen për t’iu përkushtuar programit/ rregullave të punës së bashku
- marrin në konsideratë dhe do të shprehen rreth përvojave të tyre jetësore më të rëndësishme
- ndajnë përvojën e tyre duke bashkëbiseduar në një mjedis të ngrohtë miqësor
- marrin në konsideratë, do të kuptojnë dhe do të marrin pjesë në punën me grupe që synon lehtësimin e të nxënësve
- tregojnë para grupit aftësitë/cilësitë e tyre pozitive
- kuptojnë shkaqet si dhe do të kapërcejnë problemet e mosbesimit tek vetja
- marrin në konsideratë dhe do të analizojnë sjelljet e tyre të zakonshme në situatë konflikti
- kuptojnë sjelljen e hapur
- fillojnë të praktikojnë aftësitë e të qenit të hapur dhe të sigurt në vetvete
- evidentojnë dhe shprehin qëndrimet e tyre në lidhje me pjesëmarrjen e të rinjve në projekte për rininë
- zbulojnë përfitimet që ata kanë nga pjesëmarrja, sidomos në drejtim të fitimit të eksperiencës
- vlerësojnë nivelin e pjesëmarrjes së tyre në projektin për rininë në të cilin janë përfshirë

**Kohëzgjatja:** 2 ditë

**Nr. i pjesëmarrësve:** 20-25 të rinj

**Mosha:** 14-18 vjeç

#### Rendi i ditës

AKTIVITETI	KOHA	METODA	MJETE
Prezantimi i Programit Pritshmëria për Programin Rregullat e Punës	10 min	Prezantim <i>Brainstorming</i>	
Të njohim metodën e Analizës Vlerësuese	60 min	<i>Brainstorming</i> Prezantim nga lehtësuesi Punë në grup	

- NJË QENDËR RINORE E DREJTUAR NGA VETË TË RINJTË

<b>AKTIVITETI</b>	<b>KOHA</b>	<b>METODA</b>	<b>MJETE</b>
Ushtrim për Nxemje	30 min	Forcimi i besimit tek njëri-tjetri	
Pjesëmarrësit marrin në konsideratë dhe shprehen rreth përvojave të tyre jetësore më të rëndësishme Ndajnë përvojën e tyre duke bashkëbiseduar në një mjedis të ngrohtë miqësor	60 min	Vizatim Ndarje eksperiencash në grup të madh	
Pjesëmarrësit marrin në konsideratë dhe analizojnë sjelljet e tyre të zakonshme në situatë konflikti	30 min	Prezantim nga trajneri/ bashkëbisedim <i>Brainstorming</i>	
Të kuptojmë sjelljen e hapur	15 min	Debat	
Të praktikojmë aftësitë e të qenit të hapur dhe të sigurt në vetvete	15 min	Ushtrim në grup/debat	
Të marrim në konsideratë, të kuptojmë dhe të marrim pjesë në punën me grupe që synon lehtësimin e të nxënit	30 min	Diskutim në grup/ debat	
Të tregojmë para grupit aftësitë/ cilësitë pozitive	45 min	Inventar	Inventari
Të kuptojmë shkaqet dhe të kapërcejmë problemet e mosbesimit tek vetja	45 min	Lojë	Fleta e punës
Pjesëmarrësit evidentojnë dhe shprehin qëndrimet e tyre në lidhje me pjesëmarrjen e të rinjve në projekte për rininë	15 min	Diskutim / debat	
Pjesëmarrësit zbulojnë përfitimet që ata kanë nga pjesëmarrja, sidomos në drejtim të fitimit të eksperiencës	20 min	Diskutim	Ushtrimi

<b>AKTIVITETI</b>	<b>KOHA</b>	<b>METODA</b>	<b>MJETE</b>
Pjesëmarrësit vlerësojnë nivelin e pjesëmarrjes së tyre në projektin për rininë ku janë përfshirë	20 min	<i>Brainstorming</i> , punë në grup, leksion i shkurtër	
Mbyllja	5 min		

- NJË QENDËR RINORE E DREJTUAR NGA VETË TË RINJTË

## “Të Rinjtë për të Rinjtë” Formimi i Aftësive dhe Teknikave Trajnuese

**Qëllimi:** Ndërtimi i aftësive të një grupi të rinjsh adoleshentë për të trajnuar bashkëmoshatarët e tyre

**Objektivat:** Pjesëmarrësit do të:

- njohin teknikat trajnuese
- ndërtojnë aftësi trajnuese
- ndërtojnë aftësi për të hartuar programe trajnuese
- ndërtojnë aftësi të menaxhojnë dinamikën e grupit

**Kohëzgjatja:** 2 ditë

**Nr. i pjesëmarrësve:** 20-25 të rinj

**Mosha:** 14-18 vjeç

Koha	Burimet njerëzore:	Mjedisi i trajnimit	
	• Trajneri/ja	Mjetet ndihmëse	Flipchart Markera me ngjyra të ndryshme Fletë të vogla ngjitëse me madhësi dhe ngjyra të ndryshme Letra për flipchart
<b>Sesioni 1</b> 20 min	<b>Metodologjia</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Filloni sesionin me një ushtrim për nxemje</li> <li>• Prezantoni agjendën dhe objektivat e trajnimit</li> <li>• Identifikoni pritshmëritë e pjesëmarrësve</li> <li>• Shkruani pritshmëritë dhe komentoni mbi mundësinë e arritjes së tyre</li> </ul>		
<b>Sesioni 2</b> 30 min	<b>Metodologjia</b> Cilat janë cilësitë e trajnerit efektiv? <i>Brainstorming</i> Reflektoni mbi kontributin e pjesëmarrësve dhe përmbledhni kontributin e pjesëmarrësve; shtoni idetë tuaja nëse është e nevojshme		
<b>Sesioni 3</b> 90 min	<b>Metodologjia</b> Ndani pjesëmarrësit në 5 grupe puneShpërndani nga një teknikë trajnimi për çdo grup pune dhe kërkoni që pjesëmarrësit ta lexojnë në grup dhe të përgatiten ta		

<p><b>Sesioni 3</b> 90 min</p>	<p>prezantojnë Ndani fletët e punës me instruksione të shkruara qartë mbi çfarë kërkohet nga pjesëmarrësit Jepini çdo grupi 30 minuta kohë për të lexuar dhe kuptuar si grup teknikën e caktuar dhe kërkoni që çdo grup të përgatisë një prezantim mbi teknikën në fjalë sipas strukturës që vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• përshkrimi i teknikës</li> <li>• çfarë duhet të konsideroni kur përdorni këtë teknikë</li> <li>• jepni shembuj se si mund të përdoret kjo teknikë kur jepni trajnim</li> </ul> <p>Secili grup prezanton punën për 5 minuta Trajneri kërkon që dikush nga pjesëmarrësit të përmbledhë punën e grupit</p>
<p><b>Sesioni 4</b> 90 min</p>	<p><b>Metodologjia</b> Hapni sesionin duke shtruar pyetjen: Cilat janë disa teknika të Dëgjimit Aktiv? Shkruani kontributin e pjesëmarrësve në <i>Flipchart</i>: Përmbledhni kontributin e pjesëmarrësve duke shkruar teknikat kryesore të të Dëgjuarit Aktiv:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Drejtimi i pyetjeve</li> <li>• Perifrazimi</li> <li>• Përmbledhja</li> </ul> <p>Duke përfshirë pjesëmarrësit sa më shumë në diskutim prezantoni para tyre kuptimin e secilës nga teknikat e mësipërme nëpërmjet një leksioni të shkurtër:</p> <p><b>Drejtimi i pyetjeve</b> <b>Moto</b> Po e dëgjova, e harroj Po e pashë, e kujtoj Po e bëra, e kuptoj Po mendova, do të mësoj</p> <p>Për t'i përfshirë të gjithë në diskutim ju duhet të zhvilloni aftësitë për të ditur se si t'i shtroni pyetjet; kë të pyesni; si të pyesni; çfarë informacioni të kërkoni: Ju si trajner duhet të siguroheni që të gjithë pjesëmarrësit të kenë mundësi të kontribuojnë; Pse duhet të bëjmë pyetje?</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• për të përfshirë pjesëmarrësit</li> <li>• për të zgjuar interesin e tyre</li> <li>• për të testuar nëse diçka është kuptuar në mënyrën e duhur</li> <li>• etj.</li> </ul>

*Brainstorming:*

Drejtoni pyetjet si më poshtë dhe kërkoni që pjesëmarrësit të debatojnë mbi to:

- a është më mirë t'u drejtohem pjesëmarrësve me emër apo të kërkojmë që ata të përgjigjen vullnetarisht?
- si mund të përfshini në diskutim ata që nuk flasin dhe nuk marrin pjesë?
- si veproni nëse shumica e pjesëmarrësve janë të heshtur?
- si duhet të veproni nëse dikush ju ka dhënë një përgjigje të gabuar?
- si duhet të veproni nëse nuk e dini mirë përgjigjen e pyetjes së drejtuar nga pjesëmarrësit?
- si duhet të veproni nëse dikush në grup dominon ose rithotë të njëjtën gjë?
- si duhet të veproni nëse dikush përgjigjet në një mënyrë konfuzë dhe nuk arrin të formulojë mirë përgjigjen e tij/saj?
- si duhet të veproni nëse asnjë nuk arrin t'i përgjigjet pyetjes?
- si duhet të reagoni në rast se dikush nga pjesëmarrësit bën pyetje që nuk lidhen me temën dhe e çojnë rrjedhën e diskutimit në drejtim tjetër?
- si duhet të reagoni nëse dikush nga grupi bën pyetje që s'lidhet me temën në fjalë, por zgjon një interes të madh në grup?
- si duhet të reagoni nëse pyetjes nuk i përgjigjet asnjë? A ka problem nëse trajneri përgjigjet vetë?
- si duhet të reagoni nëse trajneri nuk e di përgjigjen e pyetjes? A ndikon kjo gjë në humbjen e kredibilitetit të trajnerit?
- çfarë duhet të bëjë trajneri, nëse pjesëmarrësit nuk janë dakord me përgjigjen e tij/saj dhe argumentojnë me forcë që përgjigja është e pasaktë?

*Brainstorming:*

Sillni shembuj të llojeve të pyetjeve që njihni?

Përmblihdhni në *flipchart* duke shkruar si më poshtë:

Llojet e pyetjeve:

- pyetje të hapura
- pyetje të mbyllura (që kërkojnë përgjigje me një "po" apo "jo")
- pyetje shumëdimensionale (disa pyetje në një pyetje)
- pyetje provokuese
- pyetje testuese
- etj.

**Perifrazimi**

- Çfarë është *perifrazimi*?
- Kur përdoret?
- Avantazhet e përdorimit?
- Çfarë duhet të dini kur përdorni këtë metodë?

	<p><b>Shkruaj në flipchart kontributin e pjesëmarrësve:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- trajneri duke përdorur fjalët e veta reflekton mbi ato që thonë pjesëmarrësit për t'u treguar atyre që i ka kuptuar ose për të sqaruar më mirë atë që ata kanë dashur të thonë.....</li> </ul> <p>frazat që mund të përdoren për të filluar perifraximin:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- ju po thoni që.....</li> <li>- me fjalë të tjera.....</li> <li>- nëse ju kam kuptuar mirë, ju po thoni që.....</li> </ul> <p><b>Përmbledhja</b></p> <p><i>Çfarë është përmbledhja?</i>  <i>Kur përdoret?</i>  <i>Avantazhet e përdorimit?</i>  <i>Çfarë duhet të dini kur përdorni këtë metodë?</i></p> <p>Në momente të caktuara gjatë trajnimit trajneri duhet të identifikojë dhe të thotë elementet kryesore apo mesazhet kryesore të trajtuara deri në atë moment;  Qëllimi është:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• të përmbledhen idetë; faktet apo të dhënat kryesore së bashku</li> <li>• të kalohet tek një fazë apo element tjetër i procesit të trajnimit</li> <li>• të sigurohemi që është kuptuar ajo që po diskutohet apo trajtohet</li> </ul> <p>Procesi i përmbledhjes kërkon që:</p> <p>Të dëgjoni me shumë vëmendje që të arrini të organizoni dhe të prezantoni informacionin në mënyrë sistematike</p> <p>Frazat fillestare:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• nga puna e bërë deri tani ne mund të konkludojmë si më poshtë:</li> <li>• më lejoni të përmbledh .....</li> <li>• unë mendoj që deri tani kemi rënë dakord që të.....</li> <li>• unë mendoj se ne po themi që kemi qëllim të .....</li> </ul> <p>Vlera e vërtetë e përmbledhjes qëndron në faktin që ju jep mundësinë të testoni nëse është rënë dakord për diçka apo është kuptuar ajo që po diskutohet apo thuhej;</p> <p><b>Aplikimi:</b>  Çfarë sfidash parashikoni kur përdorni këto teknika?</p>
<p><b>Sesioni 5</b> 90 min</p>	<p><b>Metodologjia:</b>  <b>Inskenim:</b>  <b>Show televiziv</b></p> <p><b>Grupi I Çfarë të mësosh në rini do të dish në pleqëri</b>  Merrni pjesë në programin televiziv të quajtur “ Si janë kohët, ashtu është edhe morali”.</p>

<p><b>Sesioni 5</b> 90 min</p>	<p>Përfaqësoni institucionet më të rëndësishme të vendit tuaj: jeni profesor, gjyqtar, gra të besuara, deputetë etj.</p> <p>Pjesa e sotme e programit quhet “çfarë të mësosh në rini do të dish në pleqëri” dhe ka të bëjë me edukimin e fëmijëve. Detyra juaj është të vlerësoni cilësitë e mëposhtme, të cilat fëmijët duhen inkurajuar që t’i mësojnë, dhe të përcaktoni radhën e tyre – nga më të rëndësishmet tek ato më pak të rëndësishmet.</p> <p>Duhet të arrini në konsensus si grup.</p> <p>Lista e cilësive:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• vendosmëria</li> <li>• këmbëngulja</li> <li>• zbatimi i mësimëve të fesë</li> <li>• morali</li> <li>• imagjinata</li> <li>• të punosh shumë</li> <li>• edukata</li> <li>• të ndihmohesh të tjerët pa interes</li> <li>• toleranca</li> <li>• respekti</li> <li>• pavarësia</li> <li>• ndjenja e përgjegjësisë</li> <li>• të jesh i bindur</li> <li>• të kursesh (kursimi i parave dhe sendeve)</li> </ul> <p>Procesi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Për 20-25 minuta punoni si grup për organizimin e TV Show</li> <li>• Ndani rolet dhe zgjidhni drejtuesin e emisionit</li> <li>• Inskenoni për 10-15 minuta emisionin</li> </ul> <p>Reflektimi nga grupi për 20 minuta</p> <p><b>Kërkoni nga pjesëmarrësit të përmbledhin ushtrimin</b> <b>Mbyllja e trajnimit</b></p>
------------------------------------	--

## “Të Rinjtë për të Rinjtë” Praktikimi i Aftësive Trajnuese

**Qëllimi:** Ndërtimi i aftësive të një grupi të rinjsh adoleshentë për të trajnuar bashkëmoshatarët e tyre

**Objektivat:** Në fund të programit pjesëmarrësit do të:

- Demonstrjnë se i kanë përvetësuar njohuritë dhe aftësitë e zhvilluara në tre sesionet e programit “Të Rinjtë për të Rinjtë”
- Demonstrjnë se kuptojnë cilësitë dhe aftësitë që duhet të ketë një trajner/lehtësues/ndihmës të rinjsh
- Demonstrjnë aftësi të mira trajnuese dhe lehtësuese
- Demonstrjnë entuziazëm dhe dëshirë për të trajnuar bashkëmoshatarët e tyre

**Kohëzgjatja:** 2 ditë

**Nr. i pjesëmarrësve:** 20-25 të rinj

**Mosha:** 14-18 vjeç

### Rendi i ditës

AKTIVITETI	KOHA	METODA	MJETE
Çfarë gjërash të mira kanë ndodhur në jetën e pjesëmarrësve që nga trajnimi i fundit Prezantimi i programit për sesionin e tretë	30 min	Vizatime / ndarje eksperiencash / punë në grupe dyshe Prezantim nga lehtësuesi <i>Brainstorming</i>	
Cilat janë gjërat e rëndësishme që keni mësuar nga dy sesionet e mëparshme? Cilat janë disa gjëra që mendoni se do t'i përdorni në të ardhmen?	45 min	Punë në grupe treshe Prezantim nga grupet Përmbledhje nga trajneri	
Si të menaxhojmë dinamikën e grupit. Rolet e ndryshme në grup Si të mbajmë balancën?	30 min	<i>Brainstorming</i> Prezantim nga lehtësuesi	Fleta 2

- NJË QENDËR RINORE E DREJTUAR NGA VETË TË RINJTË

<b>AKTIVITETI</b>	<b>KOHA</b>	<b>METODA</b>	<b>MJETE</b>
Ushtrim për menaxhimin e dinamikës së grupit	30 min		
Metodologjia e trajnimit	45 min	Prezantim nga trajneri/ bashkëbisedim/ sjellje e shembujve nga sesionet e mëparshme	Fleta 3
Përgatitja e një sesiioni trajnimi	45 min	Prezantim/diskutim në grup	Fleta 4
Ushtrim për Nxemje	15 min		
Përdorimi me efektivitet i mjeteve ndihmëse	25 min	Prezantim Diskutim në grup	Fleta 5
Vlerësimi i trajnimit	25 min	Prezantim / diskutim në grup	Fleta 6
Ndarja e grupeve të punës dhe përcaktimi i detyrës për praktikën	30min		
Prezantimi i grupeve	135 min		
<i>Feedback</i> në grup për prezantimet	60 min		
Përmbledhja e sesionit/ vlerësimi i programit	15 min		

## “Të Rinjtë për të Rinjtë” Aftësitë Lehtësuese

**Qëllimi:** Ndërtimi i aftësive të një grupi të rinjsh adoleshentë për të trajnuar bashkëmoshatarët e tyre

**Objektivat:** Në fund të programit pjesëmarrësit do të:

- Demonstrjnë se kuptojnë cilësitë dhe aftësitë që duhet të ketë një lehtësues
- Demonstrjnë aftësi të mira lehtësuese
- Demonstrjnë entuziazëm dhe dëshirë për të lehtësuar në situata të ndryshme

**Kohëzgjatja:** 2 ditë

**Nr. i pjesëmarrësve:** 20-25 të rinj

**Mosha:** 14-18 vjeç

### Rendi i ditës

AKTIVITETI	KOHA	METODA	MJETE
Paraqitja e lehtësuesit dhe e pjesëmarrësve	25 min	<p>Lehtësuesi ndan pjesëmarrësit në 4 grupe</p> <p>Lehtësuesi ka shkruar disa pyetje në <i>flipchart</i> dhe kërkon që secili pjesëmarrës i grupit të përgjigjet për pyetjen e shtruar vetëm me një fjali</p> <p><b>Grupi 1</b> Çfarë ju pëlqen më shumë në procesin e lehtësimit?</p> <p><b>Grupi 2</b> Çfarë ju pëlqen më pak në lidhje me procesin e lehtësimit?</p> <p><b>Grupi 3</b> Cilat janë pritshmëritë tuaja në lidhje me trajnimin?</p> <p><b>Grupi 4</b> Cilat janë disa mësimet që keni nxjerrë kur keni qenë lehtësues</p>	

AKTIVITETI	KOHA	METODA	MJETE
		apo kur dikush tjetër që ju e keni vëzhguar ka qenë lehtësues?	
Luani lojën	20 min	<p>Punë në grupe:            Trajneri ndan pjesëmarrësit në 4 grupe dhe secilit grup i kërkon të vendosë në mënyrë logjike pranë e pranë "rolet dhe cilësitë e lehtësuesit"            Fiton ai grup që e mbaron detyrën i pari.            Trajneri shpërndan dy sete materialesh:  <b>Seti i kuq: Cilësitë</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Bashkëpunues</li> <li>- Adoptues</li> <li>- I organizuar mirë</li> <li>- Me nivel të lartë njohurish</li> <li>- I ndjeshëm</li> <li>- I vëmendshëm</li> <li>- Krijues</li> </ul> <p><b>Seti i zi: Rolet</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- E përshtat programin sipas rrethanave</li> <li>- I reziston dominuesit</li> <li>- Krijon dhe mban një ton respektues</li> <li>- Përdor shumë materiale apeluese vizuale</li> <li>- I dëgjon pjesëmarrësit me vëmendje</li> <li>- E njeh mirë teorikisht materialin që prezanton</li> <li>- E rregullon ambientin ku zhvillohet trajnimi në mënyrë të përshtatshme si dhe siguron se ka të gjitha mjetet mbështetëse</li> </ul>	<p>Seti i <b>cilësive</b> me shkrim me ngjyrë të kuqe</p> <p>Seti i <b>roleve</b>: me shkrim me ngjyrë të zezë</p>

AKTIVITETI	KOHA	METODA	MJETE
Prezantoni dhe komentoni punën në grup Prezantim Baza e Lehtësimit	10 min	Prezantim nga trajneri <i>Baza e Lehtësimit</i> <b>Drejtimi i pyetjeve</b> - të hapura - provokuese - kalimi tek pjesëmarrësit e tjerë - inkurajimi i pjesëmarrësve të tjerë - riformulimi i pyetjeve <b>Perifrazimi</b> <b>Përmbyllja</b>	
Praktikimi në çift	10 min	Pjesëmarrësit ndahen në çifte dhe i drejtojnë njëri-tjetrit sa më shumë pyetje të llojeve që sapo u prezantuan	
Çfarë të bëjmë me nervozizmin? Pse? Si mund ta menaxhojmë?	10 min	<i>Brainstorming</i>	
Menaxhimi i dinamikës së grupit	30 min	Prezantim nga trajneri: <b>Modeli Tukman</b> Formimi; Stuhia; Normimi; Zbatimi; Shpërndarja	
Cilat janë strategjitë e tua si lehtësues në secilën fazë?	20 min	<i>Brainstorming</i> Në grupe sipas vendeve ku janë ulur diskutohen strategjitë	
Menaxhimi i individëve të vështirë	45 min	Inskenim Lehtësuesi ka menduar për disa situata që janë të rëndësishme dhe delikate për pjesëmarrësit; Rolet janë të ndara Personi i vështirë e ka marrë rolin Zgjidhet një vëzhgues dhe një lehtësues	

- NJË QENDËR RINORE E DREJTUAR NGA VETË TË RINJTË

AKTIVITETI	KOHA	METODA	MJETE
Inskenimi		<ul style="list-style-type: none"> <li>- Luhen rolet</li> <li>- Në grup të madh ndahen eksperiencat</li> <li>- Lehtësuesi kërkon që një pjesëmarrës të përmbledhë punën në grup</li> </ul>	
Ushtrim për fillimin e seancës	10 min	Çdo pjesëmarrës shkruan në një fletë një postulat të rëndësishëm për të: Fleta bëhet si aeroplan dhe secili pjesëmarrës i nis aeroplanin e tij një pjesëmarrësi tjetër; secili pjesëmarrës lexon postulatit e shkruar në fletë;	
Teknikat e të mësuarit	20 min	<p>Ka një <i>flipchart</i> të përgatitur më përpara nga trajneri; në <i>flipchart</i> është vizatuar një shkallë; trajneri nëpërmjet teknikës <i>brainstorming</i> kërkon nga pjesëmarrësit që të plotësojnë shkallën që nga baza tek maja duke iu përgjigjur pyetjes? Çfarë influencon procesin e trajnimit/ lehtësimit?</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Ndryshimet momentale sipas situatës</li> <li>2. Preferencat personale të pjesëmarrësve</li> <li>3. Mjetet ndihmëse</li> <li>4. Afati kohor</li> <li>5. Teknikat e trajnimit</li> <li>6. Zgjedhja e pjesëmarrësve</li> <li>7. Procesi i të mësuarit për të rriturit</li> </ol>	

AKTIVITETI	KOHA	METODA	MJETE
Hartimi i sesioneve trajnuese	60 min	Lehtësuesi shpërndan një model dhe u kërkon pjesëmarrësve të përgatisin një sesion dhe ta prezantojnë; temat janë ndarë në ditën e parë të trajnimit;	
Vlerësimi	20 min	Lehtësuesi shkruan në mënyrë vertikale fjalën <b>VLERËSIM</b> dhe kërkon që çdo grup të shkruajë nga një fjalë që fillon me secilën prej shkronjave të fjalës Vlerësim; Lehtësuesi ka përgatitur një <i>flipchart</i> Modeli i vlerësimit të trajnimit 1. Reagimi i pjesëmarrësve 2. Të mësuarit 3. Sjelljet 4. Rezultati / impakti	
Mbyllja	5 min	Përmbledhja e ditës duke iu referuar objektivave; Vlerësimi i trajnimit	

- NJË QENDËR RINORE E DREJTUAR NGA VETË TË RINJTË

# MANAXHIMI I PROJEKTEVE PËR RININË

## Manual Trajneri

### Dita I --- Sesiioni I

1. **Cikli i Projektit**
2. **Vlerësimi i Nevojave në Komunitet**

**Objektivat:** Në fund të sesionit pjesëmarrësit do të mund:

- Të ndërtojnë marrëdhënie me trajnerin dhe me njëri-tjetrin; të identifikojnë pritshmëritë e tyre për programin e trajnimit dhe të bien dakord për agjendën e trajnimit
- Të kuptojnë Ciklin e Menaxhimit të Projektit
- Të njohin rëndësinë dhe procesin e vlerësimit të nevojave në komunitet

**Kohëzgjatja:** 5 orë

**Përmbajtja:** A. Prezantimi i programit  
B. Cikli i Menaxhimit të Projektit  
C. Vlerësimi i nevojave në komunitet

#### **Materiale**

**ndihmëse:** *Flipchart*, markera me ngjyra të ndryshme, projektor, letër A3.

#### **A. Prezantimi i programit**

1. Prezantimi i pjesëmarrësve dhe trajnerit; vendosja e rregullave të trajnimit;
2. Pritshmëritë e pjesëmarrësve
3. Prezantim i agjendës së programit të trajnimit.
4. Prezantim i metodologjisë së trajnimit

**Kohëzgjatja:** 60 min

#### **B. Cikli i Menaxhimit të Projektit**

**Objektivat specifike:**

- Formimi i grupeve organizative (imagjinare)
- Njohja e Ciklit të Menaxhimit të Projektit

**Kohëzgjatja:** 90 min

## Aktivitetet /Metodologjia

### Hapi 1

Pjesëmarrësit formojnë një rreth për të luajtur lojën “patatja e nxehtë”; si patate mund të përdoret ndonjë top;

Trajneri kërkon që patatja të kalojë dorë më dorë (sepse të djeg dorën) dhe kërkon që secili person që e merr në dorë të thotë një fjalë që shpjegon të kuptuarit që ata kanë për fjalën “vizion”

### Hapi 2

Jepni detyrën si më poshtë:

1. Në mënyrë individuale vizualizoni programet që ju do të donit të kryente organizata juaj pas pesë vjetësh.
2. Bëni një vizatim që shpreh vizionin tuaj; përdorni imagjinatën më të bukur;

**Koha:** 15 min

Pasi të jetë përfunduar detyra kërkonte që pjesëmarrësit të krahasojnë vizatimet e tyre dhe të gjejnë pjesëmarrës të tjerë me vizatime të ngjashme. Shpjegoni që secili grup do të formojë një organizatë imagjinare që do të formojë kontekstin për projektin.

### Hapi 3

Sapo grupet të jenë formuar, jepni detyrën e mëposhtme:

1. Secili anëtar i grupit është anëtar i të njëjtës organizatë
2. Bazuar në vizionin individual, zhvilloni një vizion për organizatën tuaj
3. Duke përdorur vizionin si bazë përgatisni një mision të thjeshtë për organizatën tuaj
4. Përgatisni dhe prezantoni vizionin tuaj tek grupet e tjera

**Koha:** 30 min

### Hapi 4

Kërkonte që grupet të prezantojnë vizionet përkatëse duke iu përgjigjur pyetjeve si më poshtë:

- Si ishte procesi i përcaktimit të vizionit? Çfarë ishte e vështirë? Çfarë ishte e lehtë?

- Si ishte procesi i përcaktimit të misionit? Çfarë ishte e vështirë? Çfarë ishte e lehtë?

### Hapi 5

Siguroni pjesëmarrësit që organizatat reale harxhojnë javë të tëra për të zhvilluar vizionet dhe misionet e tyre dhe prapë mund të ndodhë që vizionet dhe misionet e zhvilluara të mos jenë perfekte;

Shpjegoni që qëllimi i këtij ushtrimi është që jo vetëm të ushtrohemi të shkruajmë misione dhe vizione por edhe të forcojmë ndjenjën e punës në grup për një qëllim të caktuar;

Zhvillimi i vizionit dhe misionit i ndihmon organizatat të hartojnë projekte që janë në përputhje me objektivat e organizatës;

### Hapi 6

Drejtoni pyetjen si më poshtë:

Cilave pyetje duhet t'u përgjigjet organizata para se të hartojë dhe të zbatojë një projekt?

Lejoni që pjesëmarrësit të bëjnë një *brainstorming* në lidhje me pyetjen dhe kontributin e tyre pasqyrojeni në *flipchart*.

### Hapi 7

Prezantoni Ciklin e Jetës së Projektit

Gjatë prezantimit bëni komentet si më poshtë:

Cikli i jetës së projektit:

- Duhet të fillojë me një vlerësim nevojash
- Është proces i vazhdueshëm në të cilin rezultatet e monitorimit dhe të vlerësimit japin përshtypjet e tyre për të identifikuar dhe zgjidhur problemet
- Ndahet në sekuenca: disa aktivitete duhet të kryhen më përpara se aktivitete të tjera; jep shembuj:

## C. Vlerësimi i nevojave në komunitet

### Objektiva specifike:

- Të njohim rëndësinë dhe procesin e vlerësimit të nevojave në komunitet;
- Të njohim dhe të kuptojmë teknikat për mbledhjen e të dhënave
- Të identifikojmë avantazhet dhe disavantazhet e përdorimit të çdo teknike
- Praktikimi i "Teknikës së Grupit Nominal"

**Kohëzgjatja:** 2':30 min

## Aktivitetet/Metodologjia

### Hapi 1

Inicioni një diskutim për qëllimin dhe rëndësinë e procesit të vlerësimit të nevojave.

Pse është e rëndësishme të bëhet vlerësimi i nevojave? Si do ta përdorni informacionin e mbledhur?

### Hapi 2

Ndani pjesëmarrësit në grupe sipas ndarjes që u bë në fillim të sesionit dhe kërkoni që secili grup të kryejë detyrën si më poshtë:

1. Bëni një listë me metodat e mbledhjes së informacionit në lidhje me projektet e mundshme në komunitet
2. Për secilën metodë identifikoni:
  - Avantazhet e përdorimit
  - Disavantazhet e përdorimit
3. Përgatitni një *flipchart* me punën në grup

**Koha:** 30 min

### Hapi 3

Kërkoni që secili grup të prezantojë një metodë; mos lejoni përsëritje nëse është e mundur:

Për të drejtuar diskutimin drejtoni pyetje si më poshtë:

- A mendoni se kjo metodë nxit pjesëmarrjen e komunitetit?
- Cilat janë disa nga vështirësitë me të cilat duhet të përballemi kur përdorim këtë metodë?

### Hapi 4

Shpjegoni që metoda të ndryshme janë të përshtatshme për situata të ndryshme. Metoda e përdorur duhet të përmbushë nevojat e organizatës dhe të përfituesve; Kur planifikojmë procesin e vlerësimit të nevojave duhet t'u përgjigjemi pyetjeve si më poshtë:

- Nevojat e kujt po vlerësohen? Nga kush? Për kë? Pse?

### Hapi 5

Jepni një leksion të shkurtër për teknikat kryesore të cilat ndahen në metodat e mbledhjes së informacionit nga grupet dhe metodat e mbledhjes së informacionit nga individët.

Shpjegoni hap pas hapi metodën e Grupit Nominal

### Hapi 6

Kërkoni që pjesëmarrësit të ndahen në grupe për të praktikuar metodën e Grupit Nominal (shpërndani Materialin ku shpjegohet metoda)

**Detyra:** Nevojat e komunitetit të të rinjve për shërbime

**Koha:** 30 min

### Hapi 7

*Përmbliidhni ditën e parë duke iu referuar objektivave;*

## Dita 2 ————— Sesioni 2

1. Analiza e situatës
2. Lidhja shkak-pasojë
3. Identifikimi i problemeve
4. Metodrat planifikuese

**Objektivat:** Në fund të sesionit pjesëmarrësit do të jenë të aftë të:

- Kuptojnë analizën e problemeve
- Kuptojnë lidhjen shkak-pasojë
- Dinë të hartojnë qëllimet dhe objektivat e projektit
- Kuptojnë proceset e planifikimit

**Kohëzgjatja:** 5 orë

**Përmbajtja:** **A. Analiza e situatës**  
**B. Identifikimi i problemeve**  
**C. Planifikimi i projekteve**

#### A. Analiza e situatës

- lidhja shkak-pasojë
- identifikimi i problemeve
- analiza e komunitetit

**Objektivat specifike:**

1. Të kuptojmë procesin e identifikimit të problemeve nëpërmjet teknikës shkak-pasojë
2. Të kuptojmë procesin dhe rëndësinë e analizës së komunitetit

**Kohëzgjatja:** 3 orë e gjysmë

## **Aktivitetet / metodologjia**

### **Hapi 1**

Ushtrim për nxemje

Ndaju pjesëmarrësve disa fletë bosh A4. Kërko që ta gris in letrën në mënyrë të tillë që të bëhet një rreth i madh i pashkëputur në të cilin mund të futet i gjithë trupi i njeriut. Rrethi i letrës duhet të jetë i pandërprerë dhe letra duhet të gris et pa ndihmën e gërshërëve.

Kush e bën i pari ushtrimin e demonst ron para të tjerëve. Trajneri pyet nëse ky ushtrim ka lidhje me temën (planifikimi, puna në grup etj.).

### **Hapi 2**

Duke përdorur *flipchart*-in shpjegoni hap pas hapi teknikën “lidhja shkak-pasojë”. Përdorni shembuj nga jeta reale. P.sh.: rritja e aksidenteve në rrugë (shpërndani materialin e përgatitur).

### **Hapi 3**

Ka shumë mënyra për të identifikuar problemin kyç. Një ndër metodat është “Pema e problemeve”; pikturo një pemë dhe shpjego që trun gu është problem kryesor; rrënjët janë shkaqet dhe degët e gjethet janë pasojat;

### **Hapi 4**

Kërko që pjesëmarrësit të ndahen në grupet e tyre të punës dhe të hartojnë pemën e problemeve për komunitetet e tyre të rinjve;

### **Hapi 5**

Grupet prezantojnë punën e tyre si dhe procesin në të cilin kaluan;

### **Hapi 6**

Shpjegoni diagramin e problemeve sipas lidhjes shkak-pasojë; nëpërmjet *brainstorming* zhvilloni një diagram të tillë për një problem të caktuar si p.sh: shumë aksidente në rrugë; identifikoni shkaqet dhe pasojat;

Zhvilloni diagramin; ndërtoni qëllimet dhe objektivat bazuar në diagramin duke kthyer deklaratat negative në pozitive.

### **Hapi 7**

Ndani pjesëmarrësit në grupet e tyre të punës; kërkojuni të formojnë një listë me të gjitha grupet që janë të interesuara për projektin në fjalë dhe analizojini ato grupe duke vënë disa kriteret; sa pushtet kanë; sa e njohin problemin; a kanë mundësi të ofrojnë burime; a kanë interes të zgjidhet problemi?

Moto: përpiquni të gjeni se kush do ta mbështesë dhe kush do ta kundërshtojë projektin në fjalë;

Pjesëmarrësit prezantojnë punën e grupit.

### Hapi 8

Kërkoni që dikush nga pjesëmarrësit të përmbledhë elementet kryesore të sesionit.

## B. Planifikimi i projektit

### Objektivat specifike

I. Të kuptojmë rëndësinë dhe procesin e planifikimit të projektit

**Koha:** 45 min

### Aktivitetet/Metodologjia

#### Hapi I

Kërkoni që pjesëmarrësit të ndajnë eksperiencat e tyre në lidhje me planifikimin; kërkoni që ata të ndajnë histori nga jeta e tyre individuale apo shkollore në të cilat u është dashur të planifikojnë;

Përmbledhni idetë e tyre duke iu referuar elementeve kryesore të planifikimit:

**Planifikimi është një proces i vazhdueshëm që e shoqëron projektin hap pas hapi dhe ndihmon për të kuptuar që aktivitetet janë në rrjedhën e duhur;**

*Shkruani në flipchart disa nga pyetjet më të rëndësishme që marrin përgjigje nga procesi i planifikimit;*

- Çfarë do të bëhet?
- Si duhet të bëhet?
- Çfarë burimesh janë të nevojshme?
- Kush do t'i zbatojë aktivitetet?
- Kur do të bëhen aktivitetet?
- Sa kohë duhet për të kryer çdo aktivitet?
- Çfarë duhet bërë më parë?
- Çfarë aktivitetesh duhen bërë në të njëjtën kohë?
- Cili është rendi i aktiviteteve?

#### Një ndër mënyrat e planifikimit (metoda PERT)

- Bëni një listë të të gjitha aktiviteteve
- Vendosni radhën me të cilën duhet të kryhen këto aktivitete

- Vendosni se sa kohë kërkon secili aktivitet për t'u kryer
- Vendosni nëse kërkohet që dy ose më shumë aktivitete të bëhen në të njëjtën kohë?
- Bëni një diagram të kryerjes së aktiviteteve
- Gjeni kohën më të shkurtër dhe më të gjatë të kryerjes së projektit;
- Gjeni shtegun kritik

**Dita 3** ————— **Sesioni 3: Buxhetimi**  
**Sesioni 4: Monitorimi dhe vlerësimi**

**Objektivat:** Në fund të sesionit pjesëmarrësit do të mund të:

- Përshkruajnë rolin e buxhetit në ciklin e projektit.
- Vlerësojnë koston e projektit dhe të zhvillojnë një buxhet të thjeshtë
- Kuptojnë procesin dhe rëndësinë e procesit të monitorimit dhe vlerësimit

**Kohëzgjatja:** 3 orë

**Përmbajtja:** **A. Procesi i buxhetimit**  
**B. Monitorimi dhe vlerësimi**

*Aktivitetet/Metodologjia*

**A. Procesi i buxhetimit**

**Koha:** 2 orë

**Hapi 1**

Prezanto objektivat;

Ushtrim për nxemje: Makina

**Hapi 2**

Çfarë është buxheti? *Brainstorming*

Çfarë është procesi i buxhetimit? *Brainstorming*;

Bazuar në kontributin e pjesëmarrësve sqaro se çfarë është buxheti dhe buxhetimi;

**Hapi 3**

Cilat janë rolet e buxhetit?

Brainstorming

Shpjegoni që buxheti është:

- Përkthimi në shifra i aktiviteteve të projektit;
- Mjet monitorimi
- Mjet menaxhimi
- Mjet kontrolli

#### Hapi 4

Cilat janë kategoritë kryesore të buxhetit? Plotësoni kontributin e pjesëmarrësve dhe në *flipchart* zhvilloni një skicë buxheti të thjeshtë; vendosni kategoritë në të dhe disa shifra për të ilustruar;

### B. Monitorimi dhe vlerësimi

#### Objektivat:

Në fund të sesionit pjesëmarrësit do të mund të:

- Kuptojnë rolin dhe rëndësinë e monitorimit dhe vlerësimit
- Përshkruajnë qëllimin, procesin dhe komponentët e vlerësimit
- Zhvillojnë tregues të matshëm për të matur arritjen e objektivave

**Koha:** 4 orë

#### Përmbajtja:

- A. Monitorimi dhe vlerësimi i projekteve**
- B. Baza fillestare dhe treguesit**
- C. Raportimi**

### Monitorimi dhe vlerësimi

**Koha:** 2 orë

#### Aktivitetet/Metodologjia

##### Hapi 1

Çfarë është monitorimi?

*Brainstorming*

Çfarë është vlerësimi?

*Brainstorming*

Monitorimi dhe vlerësimi shkojnë bashkë dhe mbështesin njëri-tjetrin. Monitorimi është procesi i mbledhjes rutinë të informacionit dhe vlerësimi është procesi i reflektimit dhe analizës së informacionit për të mbështetur veprime për të përmirësuar diçka;

- NJË QENDËR RINORE E DREJTUAR NGA VETË TË RINJTË

Jepni shembullin e fermerit:  
Përmbliidhni si më poshtë

## VËZHGIM-MBLEDHJE E INFORMACIONIT



## REFLEKTIM—ANALIZË

## VEPRIM

## REZULTAT I PËRMIRËSUAR

### Hapi 2

Çfarë është monitorimi dhe vlerësimi në jetën e përditshme?

*Brainstorming;*

Bazuar në kontributin e pjesëmarrësve bëj pyetjen si më poshtë: si mund ta aplikoni procesin e monitorimit dhe vlerësimit në organizatën, programet dhe projektet tuaja?

## ORGANIZATË

## PROGRAM

## PROJEKT

## INDIVID

Monitorimi u përgjigjet pyetjeve?

- Çfarë?
- Si?
- Kush?
- Kur?
- Etj.

### Hapi 3

Çfarë është vlerësimi i projekteve?

Pse duhet të vlerësojmë një projekt?

- Për të marrë informacion
- Për të përmirësuar mënyrën se si menaxhohen gjërat
- Për të përcaktuar se çfarë efektesh ka programi
- Për të parë nivelin e përgjegjshmërisë
- Për të përmirësuar nivelin e njohurive në fushën e menaxhimit të projekteve

#### **Hapi 4**

Sa lloje vlerësimesh njihni?

*Brainstorming:*

Bëni një leksion mbi llojet kryesore të vlerësimit si më poshtë:

- I brendshëm dhe i jashtëm
- I procesit dhe i efektit
- Tradicional dhe me pjesëmarrje

Për secilin lloj identifikoni avantazhet dhe disavantazhet.

- Roli dhe rëndësia e vlerësimit me pjesëmarrje si lloji më i preferuar i vlerësimit

#### **Hapi 5**

Ushtrim për nxemje

Cili është fokusi i vlerësimit:

*Brainstorming*

Bazuar në kontributin e pjesëmarrësve shkruaj në *flipchart* fushat që janë në fokusin e vlerësimit:

- Efektiviteti
- Efikasiteti
- Përshtatshmëria e metodës së zgjedhur
- Ndikimi/efekti tek përfituesit
- Qëndrueshmëria

#### **Hapi 6**

Çfarë janë treguesit?

*Brainstorming:*

Janë kritere sasiore dhe cilësore për të matur realizimin e qëllimeve, objektivave dhe aktiviteteve.

Llojet e treguesve:

- Sasior dhe cilësor
- Të procesit dhe të impaktit

- NJË QENDËR RINORE E DREJTUAR NGA VETË TË RINJTË

## Raportimi

### Objektivat:

- Të kuptojmë rëndësinë e raportimit
- Të identifikojmë karakteristikat e një raporti efektiv
- Të përshkruajmë lloje të ndryshme të raporteve

### Hapi 1

Ndani fletët ku janë shkruar në mënyrë të rregullt dhe të parregullt karakteristikat e Maces, Shtëpisë, Makinës dhe Trëndafil;it;

Çfarë duhet të konsiderojmë kur shkruajmë raporte? Shkruani kontributin e pjesëmarrësve në *flipchart*.

### Hapi 2

Cilat janë disa lloje raportesh?

Sqaroni dhe shpërndani shembuj raportesh të ndryshme: tremujore, përmbyllëse, vlerësimi, vlerësimi nevojash, trajnimi etj.

### Hapi 3

Përmbliidhni pikat kryesore të ditës duke iu rikthyer objektivave të vendosura për këtë ditë



# Një Qendër Rinore e drejtuar nga vetë të rinjtë

Nga përvoja e Qendrës Rinore në Kuçovë

Save the Children në Shqipëri  
Rr. Komuna e Parisit , Vila “Lami”  
Tiranë, Shqipëri.  
Tel.: +355 42 266227 / 261840  
e-mail: [savealbania@savealbania.org](mailto:savealbania@savealbania.org)  
P.O. Box 8185



QËNDRA RINORE  
KUÇOVË



Save the Children